



RAPORT

MBI SITUATËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA
NË KOMISARIATET E POLICISË SË SHTETIT,
NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE
NË SPITALET PSIKIATRIKE

MONITORIMET JANË REALIZUAR GJATË PERIUDHËS
Korrik 2015 – Janar 2016



RAPORT

MBI SITUATËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA
NË KOMISARIATET E POLICISË SË SHTETIT,
NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT
DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE
DHE NË SPITALET PSIKIATRIKE

MONITORIMET JANË REALIZUAR GJATË PERIUDHËS
Korrik 2015 – Janar 2016

Ky publikim realizohet në kuadër të projektit “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, mbështetur financiarisht nga Civil Rights Defenders me fonde të Qeverisë Suedeze, dhe në kuadër të projektit “Së bashku kundër torturës në polici dhe në burgje në Shqipëri”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Këto projekte janë zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk shpreh domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Qeverisë Suedeze dhe në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar se reflekton qëndrimin e Civil Rights Defenders dhe të Bashkimit Evropian.

Supervizim dhe redaktim shkencor: Vjollca Meçaj, Drejtore Ekzekutive

Udhëheqëse e projektit: M.A Klejda Ngjela

Punuan raportin: M.A. Klejda Ngjela dhe M.A Iva Bregasi

Monitoruesit e institucioneve: Lista bashkangjitur

Përkthimi: Anri Pashaj

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Ap. 10, K. 5, K.P. nr. 1752, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: ++355 (0)4 223 36 71, ++355 (0)69 407 57 32

web address: www.ahc.org.al

E-mail: office@ahc.org.al

Botues: @ Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
1. PËRMBLEDHJE PËR SITUATËN NË INSTITUCIONET E POLICISË.....	9
2. PËRMBLEDHJE PËR SITUATËN NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT/BURGJE.....	12
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR SITUATËN NË SPITALET PSIKIATRIKE.....	18
METODOLOGJIA E VËZHGIMEVE.....	21
 KREU 1. SITUATA NË KOMISARIATET E POLICISË	
1. GJETJE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONE E POLICISË.....	25
1.1 E DREJTA PËR TRAJTIM DINJITIZ.....	25
1.1.1 TORTURA DHE KEQTRAJTIMI.....	25
1.1.2 PËRDORIMI I FORCËS.....	27
1.1.3 PROCEDURA E MARRJES NË PYETJE.....	28
1.1.4 E DREJTA PËR KËRKESË-ANKESË	30
1.1.5 PROCEDURA E TRANSFERIMIT.....	31
1.1.6 KUSHTET INFRASTRUKTURE.....	32
1.2 E DREJTA E NJOFTIMIT TË ARSYES SË SHOQËRIMIT/ NDALIMIT / ARRESTIMIT/ DHE NJOFTIMI I FAMILJARËVE.....	34
1.3 E DREJTA PËR T’U MBROJTUR ME AVOKAT.....	35
1.4 E DREJTA PËR SHËRBIM SHËNDETËSOR.....	36
1.5 KONSTATIME TË TJERA.....	37
I. SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET E POLICISË	39
 KREU 2. SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE (BURGJE)	
2. GJETJE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONET PENITENCIARE.....	41
2.1 MBIPOPULLIMI.....	41
2.2 KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCIONET PENITENCIARE.....	43
2.3 SIGURIA DHE TË NDJERIT TË SIGURT.....	46

2.4	TRAJTIMI I TË DËNUARVE, REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI, INDIVIDUALIZIMI I DËNIMIT, PROGRAMI DITOR.....	48
2.5	E DREJTA E KËRKESËS DHE E ANKESËS.....	49
2.6	KUJDESI SHËNDETËSOR.....	50
2.7	POLITIKA DISIPLINORE NË INSTITUCIONET VENDORE PENITENCIARE.....	53
2.8	LEJET SHPËRBLYESE DHE ATO TË VEÇANTA.....	54
2.9	PUNËSIMI.....	56
2.10	TRAJTIMI I GRUPEVE NË POZITA TË DOBËTA: TË MITURIT, GRATË, TË SËMURËT MENDORË ETJ.....	56
2.11	KONSTATIME TË TJERA.....	63
II.	SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET PENITENCIARE.....	64

KREU 3. SITUATA NË SPITALET PSIKIATRIKE

3.	GJETJE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE QË VUAJNË NGA ÇRREGULLIME TË SHËNDETIT MENDOR NË SPITALET PSIKIATRIKE.....	68
3.1	PERSONELIMJEKËSOR.....	68
3.2	PRANIMI NË INSTITUCION.....	69
3.3	AKOMODIM.....	69
3.4	TRAJTIMI I PAVULLNETSHËM DHE MJEKIMI I DETYRUAR.....	71
3.5	KUFIZIMI FIZIK.....	72
3.6	E DREJTA PËR USHQIM.....	73
3.7	AKTIVITETET REHABILITUESE.....	74
3.8	HIGJIENA PERSONALE DHE VESHJET.....	75
3.9	MARRDHËNIET ME BOTËN E JASHTME.....	75
3.10	MARRDHËNIET PACIENT-STAF.....	76
III.	SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR NË SPITALET PSIKIATRIKE.....	76

LISTA E MONITORUESVE TË INSTITUCIONEVE.....	78
---	----

LISTA E SHKURTIMEVE TË EMRAVE

DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
IVM	Institucion i Veçantë për të Miturit
IVSHB	Institucion i Veçantë i Shërbimit të Burgosurve
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OPGJ	Oficerë i Policisë Gjyqësore
SHKBSH	Shoqata Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë
SKV	Sektor i Kujdesit të Veçantë
SP	Spital Psikiatrik
QSUT	Qendra Spitalore Universitare Tiranë

HYRJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) i krijuar në 16 Dhjetor 1990, ka si mision të tij promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Në kuadër të përmbushjes së këtij misioni, KShH e ka shtrirë, prej disa vitesh, veprimtarinë e tij edhe në institucionet e mbyllura, ku qëndrojnë personat të privuar nga liria, konkretisht, në drejtoritë dhe komisariatet e policisë dhe në institucionet e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit (burgje). Gjithashtu, vitet e fundit, jemi fokusuar edhe në mbikëqyrjen e respektimit të të drejtave të personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, ose që qëndrojnë në Spitalet Psikiatrike me Shtretër. KShH ka përdorur forma të ndryshme pune për të verifikuar situatën e respektimit të lirive dhe të drejtave të kësaj kategorie shtetasish dhe për të nxitur përmirësimin e situatës, por midis tyre monitorimi me grup ekspertësh të pavarur mbetet forma kryesore e ndërhyrjes.

Policia e Shtetit luan një rol mjaft të rëndësishëm në një shtet demokratik, për shkak se vepron, drejtpërdrejtë për garantimin e sigurisë dhe rendit publik. Ky funksion i saj duhet të udhëhiqet nga parimet e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Po ashtu, institucionet penitenciare kanë për mision mbajtjen dhe trajtimin e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale, ose të dënuar nga gjykata për këtë arsye, me qëllim që të mundësohet dhënia e drejtësisë për ta, ose rehabilitimi shoqëror, në përputhje me rregullimet legjislative në fuqi.

Nga ana tjetër, institucionet e specializuara për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, kanë për detyrë të kujdesen që këta persona të marrin shërbimin e nevojshëm shëndetësor, pa u diskriminuar dhe duke ju ofruar të gjitha mundësitë të përfshihen në këtë shërbim dhe të gëzojnë të drejtat e tyre, për aq sa mundëson gjendja e tyre shëndetësore, në përputhje me protokollet mjekësore dhe standardet e parashikuara në ligj.

Gjatë vizitave monitoruese, ekspertët kanë verifikuar me kujdes respektimin e të drejtave kushtetuese, konventore dhe ligjore, që gëzojnë këta shtetas, por veçanërisht jemi ndalur tek njoftimi i shtetasve për shkaqet e kufizimit të lirisë; respektimi i të drejtës për t'u ankuar ndaj këtij kufizimi; verifikimi i pasqyrimin saktësisht të momentit të kufizimit të lirisë, në dokumentacionin përkatës; njoftimin e të drejtave të personave të ndaluar dhe të arrestuar, veçanërisht të drejtës për t'u mbrojtur me avokat; respektimi i të drejtës për ajrim, i të drejtës për kërkesë dhe ankesë; i të drejtës për të përfutur nga lejet shpërblyese; i të drejtës për shërbim

shëndetësor falas; i të drejtës për të mbajtur komunikim me familjarët dhe miqtë personal, pa patur kontroll në komunikimin me ta, etj.

Fokus i veçantë monitorimi, ka qenë respektimi i të drejtave të personave pjesë e shtresave vulnerabël të shoqërisë si: të miturit, gratë dhe personat, të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor etj.

Vlen për t'u përmendur se misionet e monitorimit janë realizuar në një frymë bashkëpunimi konstruktiv me autoritetet e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe vet administratës së institucioneve të monitoruara. Një qasje e tillë bashkëpunimi krijon kushte të favorshme për përmirësimin e situatës së të drejtave të personave që mbahen në institucionet e lartpërmendura, dhe ofron mundësi më të mira për plotësimin e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare, që përbëjnë dhe një detyrë të rëndësishme në kuadër të procesit të integritetit evropian të vendit tonë.

Në këtë botim janë përfshirë, në mënyrë të përmbledhur, gjetjet konkrete, që na kanë rezultuar nga misionet e monitorimit, gjatë vitit 2015, të cilat i kemi krahasuar me standardet e parashikuara në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar. Raporti përmban një qasje krahasuese me raportet e publikuara nga KShH në vitet paraardhëse, sepse gjetjet e këtij viti i kemi krahasuar edhe me konkluzionet e monitorimeve të viteve të mëparshme, duke mundësuar evidentimin, sipas rastit, progresin, ose rënien e standardeve. Botimi përmban, gjithashtu, sugjerime për marrjen e masave që do të përmirësonin situatën e konstatuar.

Nën këtë këndvështrim, KShH ka realizuar misione monitorimi të planifikuara dhe sporadike, përkatësisht duke u bazuar në një plan paraprak monitorimi, apo në bazë të ankesave të marra nga ankues të ndryshëm, për të vlerësuar nga afër respektimin e të drejtave që i përkasin këtyre grupeve individësh.

KShH shpreson që gjetjet dhe rekomandimet e propozuara në këtë raport do të nxisin vendimmarrësit, e institucioneve publike përkatëse, të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për përmirësimin e gjendjes aktuale, si dhe do të frymëzojnë individët me liri të kufizuar, që gjenden në këto institucione, familjarët e tyre dhe publikun e gjerë, të reagojnë ndaj shkeljeve të mundshme të të drejtave të tyre. Shoqëria jonë ka nevojë për shtetas të informuar, të përfshirë dhe pjesëmarrës në të gjithë proceset e zhvillimit dhe integritetit të vendit, sepse vetëm kjo do të demokratizonte jetën tonë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. PËRMBLEDHJE PËR SITUATËN NË INSTITUCIONET E POLICISË

Gjatë periudhës Korrik 2015 – Janar 2016, KShH, ka monitoruar situatën e respektimit të të drejtave të personave në ambientet e komisariateve dhe të stacioneve policore. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe, janë realizuar 22¹ misione monitoruese, në 20 institucione policore, 2 prej të cilave janë monitoruar 2 herë. Raportet përkatëse të monitorimit kanë konkluduar me gjetje konkrete dhe rekomandime për përmirësimin e situatës. Konkretisht kanë rezultuar gjetjet si vijon, të cilat i kemi grupuar sipas natyrës së tyre:

Rezulton se përgjithësisht personave i garantohen të drejtat e tyre procedurale. E drejta për t'u mbrojtur me avokat zbatohet, edhe pse vetëm formalisht. Personave i caktohet një avokat kryesisht nga lista e avokatëve, kur nuk kishin mundësi financiare të merrnin një avokat të zgjedhur prej tyre. Rezultoi një bashkëpunim i mirë me spitalet rajonale për personat në nevojë, (përmendim këtu shërbimin e ofruar për personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor). Vlerësohet pozitivisht mbyllja e dhomave të shoqërimit apo të sigurisë që nuk i plotësojnë standardet e shprehura në legjislacion dhe nuk janë më të përdorshme për personat e ndaluar dhe të arrestuar, si dhe rikonstruktimi i disa dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë. Situata me transferimet në Tiranë është përmirësuar gjatë vitit 2015.

Ushqimi përgjithësisht u cilësua i mirë. U vu re një shtim i punonjësve femra në Policinë e Shtetit. Kjo nismë vlerësohet pozitivisht nga KShH pasi ndihmon me balancimin gjinor të punësimit në këtë sektor, po ashtu edhe garantimin e të drejtave të të shoqëruarave/ndaluarave femra në këto institucione. Si një praktikë të mirë përmendim Komisariatin e Beratit ku janë punësuar 17 punonjëse femra me uniformë.

1. Për më shumë informacion shih tek "Metodologjia e monitorimeve";

Është konstatuar se jo gjithmonë përmbushet menjëherë detyrimi ligjor për njoftimin e **arsyeve të shoqërimit, ndalimit, apo arrestimit dhe për pasojë kufizimit të lirisë dhe të drejtave të shtetasve**, që në momentet e kontaktimit nga organet e policisë. Personat nuk pajisen gjithmonë me kopjen e deklaratës së të drejtave që gëzojnë, gjatë trajtimit në polici, ndonëse pretendohet se komunikimi i tyre bëhet rregullisht. Realizohet rregullisht njoftimi i familjarëve kur personat madhorë e dëshirojnë dhe e kërkojnë një gjë të tillë, por kur personi është i mitur njoftimi bëhet detyrimisht, edhe në rastet kur i mituri nuk e dëshiron një gjë të tillë.

Shqetësuese mbetet **përdorimi i forcës jo proporcionale**, në disa raste, nga ana e forcave të policisë. Gjatë vitit 2015 janë bërë publike nga mediat, por është pretenduar edhe nga vetë të interesuarit, në disa raste, ushtrimi i dhunës, jo proporcionale nga ana e punonjësve të policisë. Kjo ka ndodhur, kryesisht, në momentet e arrestimit. Pretendime për dhunim janë adresuar edhe ndaj procesit të marrjes në pyetje, apo gjatë shoqërimit për në ambientet e policisë. Nuk kanë munguar pretendime për dhunë edhe nga të miturit² (në Komisariatit Nr.5 Tiranë dhe Komisariatit e Elbasanit).

Paraqitet problematik gjatë procesit të marrjes në pyetje, fenomeni i mbivendosjes së pozicioneve të juristit të institucionit dhe atij të psikologut, në strukturat vendore të policisë, funksione me profil arsimit të ndryshëm nga njëri-tjetri, që efektivisht rezultoi se funksionarët përkatës të policisë nuk i plotësonin që të dyja. Sipas rastit nëpunësi ishte jurist dhe nuk kishte kryer studime për psikologji, ose anasjelltas, sipas rasteve³. Kjo çënon një nga garancitë ligjore bazë të ofrimit të shërbimit psikologjik, sidomos në rastet e të miturve të privuar nga liria, të personave më aftësi mendore të kufizuara, ose të viktimave të krimeve të rënda, kur ligji parashikon ndërmjetësimin e psikologut gjatë komunikimit me ta, në kuadër të procedimit penal. Po ashtu, në disa raste, ka rezultuar mungesë e dhomave të veçanta për mbajtjen e të miturve, të grave dhe vajzave.

Avokatët e caktuar kryesisht, në shumicën e rasteve, takonin të ndaluarin/ arrestuarin vetëm në procesin gjyqësor për caktimin e masës së sigurisë dhe jo më parë. Nga të interesuarit u pretendua se mungonte, në mënyrë të theksuar, cilësia dhe efektiviteti i shërbimit të ofruar nga këta avokatë.

Sa i takon **të drejtës për trajtim dinjitoz**, janë gjetur raste kur personat flenë në dysheme, në dhoma me kapacitet për një person, për shkak të mbipopullimit. Në disa raste të tjera dhomat nuk i plotësojnë standardet

2. Pretendime të marra gjatë intervistimeve të të miturve që mbaheshin në IVM Kavajë;

3. Nga monitorimi i 20 komisarateve të policisë në të gjithë vendin, nuk na ka rezultuar ndonjë rast ku juristi të jetë arsimuar edhe në degën e psikologjisë apo anasjelltas;

ligjore të hapësirës në dispozicion të një personi që i është kufizuar liria. Vijnë të mbetet e njëjta situatë lidhur me procedurën e mbylljes së këtyre dhomave duke mos ndjekur rregullat e miratuara për mbylljen e tyre me vullë dhe dyllë.

Nga vizitat monitoruese ka rezultuar se ka mungesë higjiene në disa prej ambienteve të shoqërimit dhe ndalimit, si dhe ambientet e dusheve dhe tualeteve. Në disa raste këto mjedise janë në gjendje tepër të mjerueshme. Ka rezultuar po ashtu ndriçim jo i mjaftueshëm natyral apo artificial, ajër i rëndë në ambiente ku mbahen personat me liri të kufizuar, lagështirë, shtroje jo të pastra individuale etj...

Sa i takon **shërbimit shëndetësor**, në organet e Policisë së Shtetit vazhdon të jetë e njëjta situatë si në vitet e kaluara. Shërbimi mjekësor ofrohet nga mjekët e Drejtorive Vendore të Policisë⁴ që janë në varësi të DPSH ose në një rast sporadik që u verifikua nga mjeku, që ishte pjesë e organikës së institucionit në IEVP, në raste kur komisarati i policisë ndodhej afër me burgun, ose paraburgimin. Mungesa e medikamenteve mjekësore, apo e pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi është ende problem në shumë komisarate.

Ushqimi përgjithësisht realizohej nëpërmjet sigurimit të shërbimit katering, por pati pretendime lidhur me cilësinë dhe sasinë e tij në disa prej institucioneve të monitoruar.

Sa i takon të drejtës së personave, që mbahen në ambiente të policisë, për të bërë kërkesa-ankesa dhe për të marrë përgjigje lidhur me to, rezultoi se këta shtetas, në shumicën e rasteve, i adresonin ato në mënyrë verbale, direkt tek punonjësit e dhomave të sigurisë. Në regjistrat e këqyrrur rezultojnë vetëm disa kërkesa. Në Komisaratin Nr.4 Tiranë, efektivisht mungonte regjistri i kërkesë-ankesave. Personeli na shpjegoi se kërkesë-ankesat e mundshme i shënonin në regjistrin e hyrjeve-daljeve. Objekti i kërkesave më së shumti konsistonte në kërkimin e takimit me avokatët personal.

Vijnë të mbetet problematik **transferimi i vonuar dhe tej afateve ligjore i personave, që kanë marrë masën e sigurisë, ose të arrestuarve për të vuajtur dënimin e formës së prerë**, në IEVP-të përkatëse. KSHH ka konstatuar se këto vonesa zgjatin deri në rreth 13 ditë qëndrimi në komisariat në pritje të transferimit.

4. Referuar terminologjisë së re në Nenin 21 në Rregulloren e Policisë së Shtetit miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015; http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/167-2015.pdf;

2. PËRMBLEDHJE PËR SITUATËN NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT/BURGJE

Janë marrë masa nga institucionet kompetente për të përmirësuar disi situatën e **mbipopullimit** në sistemin penitenciar. Krahësuar me të dhënat e një viti më parë, ku mbipopullimi arrinte në rreth 32 % në gjithë sistemin penitenciar, në sistemin e burgjeve ndodhen aktualisht 6282 persona⁵, ndërkohë që kapaciteti është 5484 persona, pra janë 798 persona, rreth 14.5% mbi kapacitet. Janë hapur institucione të reja në IP Berat dhe IEVP Fier⁶ (me kapacitet 600 të dënuar dhe 180 të paraburgosur), si dhe është vënë në rifunksionim IEVP “Jordan Misja” Tiranë, pas rikonstruksioneve të realizuara. Po ashtu, me miratimin e Ligjit Nr. 154/2015 “Për dhënie amnistie”⁷ u liruan në Janar të 2015, 968 të dënuar, fakt i cili gjithashtu uli mbipopullimin në burgje. Lidhur me personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor dhe që qëndrojnë brenda sistemit penitenciar, KShH ka marrë dijeni se Ministrisë së Drejtësisë (Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve) dhe Ministrisë së Shëndetësisë ju janë vënë në dispozicion nga qeveria dy troje për ndërtimin e dy institucione, që do t’u shërbejnë personave me probleme të shëndetit mendor, përkatësisht personave me masë mjekësore dhe personave të dënuar që gjatë vuajtjes së dënimit janë sëmurur nga sëmundje mendore.

Trajtimi i të miturve në burgje e paraburgime, na ka rezultuar se ishte në vëmendje të institucioneve kompetente. Në të gjitha institucionet ku mbahen të mitur ofrohet arsimimi 9 vjeçar i tyre. Në IVM Kavajë zhvillohej programi mësimor në 4 klasa, dy i përkisnin ciklit të ulët dhe dy të tjerat ciklit të lartë. Shkolla funksiononte çdo ditë, nga ora 08:15 me 13:00 për ciklin e lartë dhe nga ora 08:15 me 11:45 për ciklin e ulët. Për rehabilitimin e tyre ndërmerren programe të veçanta trajtimi dhe rehabilitimi, si dhe kurse profesionale të ndryshme (për hidraulik, elektrik dhe punë me

5. Faqa zyrtare e DPB, të dhëna për muajn Janar 2016, Këto shifra kanë rezultuar pas aplikimit të ligjit për amnistinë ku u liruan 968 të dënuar, <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=580>

6. Referuar Faqes Zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=96> ;

7. Faqa zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë http://www.parlament.al/web/pub/ligj_nr_154_dt_21_12_2015_25096_1.pdf

dru, megjithëse rezulton të ketë mungesë të furnizimit me lëndë të parë dhe materiale të nevojshme për punë). Ndër të tjera, pjesën më të madhe të kohës e kalojnë jashtë dhomës duke parë TV ose duke marrë pjesë në aktivitete sportive të ndryshme. Klima në disa institucione ku mbahen të mitur është përmirësuar. Në këtë kuadër, vlen të përmendet iniciativa e fundit, që KShH po ndërmerr në kuadër të një projekti⁸ që zbatohet nga Komiteti Holandez i Helsinkit, i mbështetur nga fondet e Ministrisë së Jashtme Holandeze, i cili ndër të tjera, synon rehabilitimin e plotë të të miturve në shoqëri, pas daljes nga institucionet penitenciare. Një nga shtyllat bazë të kësaj iniciative është qasja edukative që iu ofrohet të miturve në institucione penitenciare nga personeli i mirë trajnuar, në mënyrë që ata të ndryshojnë sjelljet të cilat i kanë sjellë në konflikt me ligjin. Shërbim shëndetësor rezultoi mjaft i mirë ku çdo i mitur ishte i pajisur me kartelën e tij mjekësore dhe të plotësuar në mënyrë periodike në institucionet ku mbahet kjo kategori.

Në IEVP “Ali Demi” ofrohet plan gjithëpërfshirës ndaj grave për riintegrimin e tyre dhe janë marrë masa për zbatimin e programit të prindërimit në distancë duke krijuar kushte të duhura në ambientet përkatëse të dhomës së takimit. Dhoma ishte në kushte të mira, me piktura të përshtatura për të ofruar një ambient të këndshëm edhe për fëmijët. Gjithashtu praktikohet prindërimi në distancë deri në 8 orë në ditë, por mesatarisht nënat me fëmijët e tyre rrinë deri në 2 orë në ditë. Këto të fundit i takojnë fëmijët e tyre tek dhomat e takimit. Sa i takon **shërbimit shëndetësor, na rezultoi se** gratë e paraburgosura, para së të pranoheshin në institucion, i nënshtrohen vizitës gjinekologjike dhe ECHO-s për të përcaktuar statusin e tyre riprodhues. Lidhur me realizimin e aktiviteteve janë evidentuar raste pozitive, të organizimit të terapive muzikore dhe të punimeve me dorë (grip) në IVSHB, apo edhe larmishmëria e aktiviteteve të ofruara në IEVP “Ali Demi” Tiranë. Institucioni prej vitesh ka vënë në funksionim serën e vet, ku janë të punësuar disa gra të cilat merren me rritjen e luleve apo perimeve të ndryshme. Sa i takon trajtimin të tyre institucioni ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me organizata jo fitimprurëse, për realizimin e programeve prag-lirimi. Në këtë institucion ofroheshin kurse për rrobaqepësi, parukeri dhe anglisht. Aktivitetet e realizuara konsistonin në lojëra me letra, domino, lojëra me top, kinema, terapi arti, etj.

Ka rezultuar se e drejta e kërkesë ankesave respektohet konform procedurave të miratuara dhe në këtë drejtim nuk paraqiten ankesa nga të dënuarit. E drejta për ushqim cilësor duke konsumuar ushqimet

8. “Përmirësimi Kushteve për Riintegrimin e të miturve të burgosur në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë”, Programi Matra CoPROL” financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme në Holandë”;

e stinës është respektuar më së mirë në IVSHB Tiranë, ku vakti ditor ishte i larmishëm dhe i ruajtur me kujdes, me racionet përkatëse për diabetikët e të tjerë me sëmundje të ndryshme. Përgjithësisht, procedura për dhënien e lejeve shpërblyese dhe të veçanta është zbatuar konform rregullave ligjore.

Gjatë vitit 2015 **mbipopullimi** ka vijuar të jetë një nga problemet më të rënda i sistemit penitenciar në tërësi. KShH ka evidentuar një rast ku mbipopullimi ka arritur deri në 100%. Ashpërsimi i dënimeve të disa veprave penale, dhënia në masë e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe aplikimi i pakët i dënimeve alternative, kanë rezultuar të jenë disa nga arsyet kryesore që e kanë ‘ushqyer’ atë fenomen.

Për sa u takon kushteve të infrastrukturës, përgjithësisht është konstatuar gjendje jo e mirë në shumë institucione (katet e para të ndërtesave të amortizuara, mungesë shtretërish për të gjithë të burgosurit, mos plotësim i standardeve ligjore referuar hapësirës për person, etj...). Në mjaft institucione mbizotëronte lagështira e cila ishte prezent në pothuaj të gjitha ambientet, por më tepër në mjediset pranë tualeteve dhe dusheve, për shkak të izolimit jo të mirë të tubacioneve, ose të cilësisë së ulët të punimeve të kryera. Ajo çka është për t’u evidentuar që nevojiten të marren masa të menjëhershme është amortizimi i lartë që ka IEVP Ali Demi për sa i takon infrastrukturës. Po ashtu, ambientet e veçimit nuk plotësojnë standardet e ndriçimit natyral dhe të aksesit nga punonjësit e institucionit.

Në disa institucione është konstatuar se nuk funksionon **sistemi i ngrohjes**, ku rasti më flagrant u paraqit në IVSHB Tiranë, problem i cili vijon që prej 2 vitesh dhe ende nuk janë marrë masa për vënien në funksionim të sistemit. Në ditët e ftohta të dimrit, veçanërisht në institucione ku lagështira në mjedisë është tepër prezente, situata krijon kushte për trajtim çnjerëzor e degradues, sidomos për personat në gjendje të veçantë si, të sëmurë, të mitur, gra, të moshuar etj.

Higjiena u paraqit problematike në pjesën më të madhe të institucioneve të monitoruara. Kjo për arsye se një pjesë e kategorisë së personave që qëndrojnë në burgje nuk janë të aftë, nga gjendja shëndetësore, për t’i shërbyer vetes dhe për të mbajtur pastër mjedisin e tyre. U konstatua se kishte mungesë të detergjentëve dhe në mjaft raste të dënuarit i siguronin ato nga të afërmit, me shpenzimet e tyre.

Në pjesën më të madhe të institucioneve të monitoruara **dushet dhe tualetet** nuk ishin në gjendje të mirë. U konstatuan dyer të ndryshkura e të thyera, lagështirë e theksuar, kokat e dusheve të dëmtuara, amortizim i pllakave, papastërti dhe tubacione të dëmtuara dhe për pasojë, në një rast sporadik, u konstatua dalja e ujërave të zeza në mjedisin përreth tualeteve.

Disa institucione u paraqitën problematike lidhur me furnizimin me uji 24 orë në ditë. Në IVM Kavajë uji rezultonte i ndotur me bakterie të rrezikshme, me “Esheriakoli”, dhe rrezikonte përhapjen e sëmundjeve. Ky ujë me këtë cilësi ishte i ndaluar për t’u përdorur për t’u pirë dhe mjaft i rrezikshëm për larjen e enëve dhe teshave.

Ka patur pretendime të shumta lidhur me **cilësinë e ushqimit dhe shumëllojshmërinë** e tij. Fakt ky i konstatuar dhe nga verifikimi i regjistrave, ku shënohet menuja e ushqimit. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e marrin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë.

Siguria dhe të ndjerit të sigurt janë elemente të rëndësishme të trajtimit të të burgosurve. Tentativat për vetëvrasje dhe vetëvrasjet vazhdojnë të jenë prezent. Forma më e skajshme e cënimit të sigurisë personale, e pretenduar gjatë monitorimeve, ishte ai i parashtruar nga një i dënuar, që u shpreh se ndaj tij ishte kryer abuzim seksual me dhunë nga një i dënuar tjetër. Mbi sinjalizimin tonë autoritetet përkatëse morën masa, të menjëhershme, për sqarimin e situatës, por duhet bërë kujdes nga autoritetet që të krijojnë mundësi reale dhe të besueshme për të burgosurit, që sinjalizime të tilla t’i marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të dëmtuarit dhe të rrezikuarit. Gjithashtu duhet rritur vigjilenca ndaj sjelljeve të tilla. Shqetësuese mbetet dhe fenomeni i kalimit të sendeve të ndaluara në mjediset e burgimit dhe paraburgimit, që tregojnë kapacitete, ose integritet të nivelit të ulët të stafeve që ushtrojnë kontroll për këtë qëllim.

(sende të ndaluara, që kanë kaluar në burgje, pa u identifikuar, varjojnë nga celularë e deri tek armë të ftohta.)

Sa i takon të drejtës për të drejtuar **kërkesë - ankesa**, nga regjistri i posaçëm rezultojnë vetëm kërkesa ku pjesa më e madhe e tyre konsiston në: telefonata shpesh, takime me familjarë, transferim dhomë, etj... Megjithatë KShH vazhdimisht merr ankesa nëpërmjet telefonit apo letrave që i adresohen nga shumë të burgosur për çështje që lidhen me trajtimin në institucionet penitenciare apo për çështje ligjore të caktuara, gjë që tregon se ka probleme me administrimin dhe trajtimin e kërkesë-ankesave të personave me liri të kufizuar, që trajtohen në institucione penitenciare.

Është konstatuar se **aktivitetet** më të shumta që realizoheshin me të burgosurit dhe paraburgosurit ishin lojërat e tavolinës, siç janë lojëra me letra dhe domino. Por, organizoheshin dhe takime individuale, takime në grup, takime këshilluese, ose trajtimi i temave të ndryshme për higjienën, drogën, alkoolin, etj.. Aktivitet sportive rezultoi se nuk

ishin të shpeshta për arsye të ndryshme. Pjesën më të madhe të ditës të burgosurit e kalojnë në dhomë duke mos plotësuar kështu parashikimet ligjore që përcaktojnë ndryshe.

KShH i ka kushtuar një rëndësi të veçantë **respektimit të të drejtës për shërbim shëndetësor falas, pa diskriminim**. Gjatë vitit 2014 KShH ka paraqitur në Gjykatë një kërkesë me objekt garantimin e shërbimit shëndetësor dhe ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor e degradues si pasojë e mosdhënies së këtij shërbimi⁹. Gjykata përkatëse e pranoi këtë kërkesë dhe me vendimin e saj të vitit 2015, urdhëroi ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor nga DPB me qëllim që të ndërpritej trajtimi çnjerëzor. Shërbimit shëndetësor i mungojnë mjekët psikiatër që punojnë në këtë sistem. Po ashtu, ka ankesa të shumta për cilësinë e shërbimit apo të medikamenteve që ofrohen në institucionet penitenciare. Referuar statistikave të KShH-së rreth 30% e ankesave të marra gjatë 2015 lidhen me shërbimin shëndetësor në sistemin penitenciar. Shërbimi mjekësor që ofrohet në IVSHB lë shumë për të dëshiruar, si në aspektet e infrastrukturës së këtij institucioni, po ashtu edhe sa i takon shërbimit mjekësor që marrin të sëmurët. Në IEVP Tepelenë, Durrës, etj... kishte mungesë të pajisjes me librezë shëndetësore të shumë të burgosurve, e cila është garanci për të përfituar medikamentet nga skema e rimbursueshme. Është konstatuar në disa raste mungesë e personelit mjekësor dytësor, e medikamenteve dhe e pajisjeve të nevojshme mjekësore për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore.

Masa disiplinore, që është dhënë më shpesh në institucionet e monitoruara ka rezultuar të jetë përjashtimi nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë. Kjo masë më pas ndiqet nga masa disiplinore përjashtimi nga ajrosja në grup. Sa i takon procedurës së ndjekur për dhënien e masës, janë evidentuar raste, sporadike, të mos respektimit, me rigorozitet, të normave procedurale të parashikuara në ligj e rregullore, si p.sh. urdhri i drejtorit të IEVP-së për dhënien e masës disiplinore nuk përmbante shprehimisht të drejtën e ankimit të masës së dhënë në Komisionin e Apelimit të Masave Disiplinore.

Sa i takon respektimit të së drejtës për përfitimin e lejes shpërblyese, në IEVP “Ali Demi” është evidentuar një rast ku drejtori ka miratuar dhënien e lejes shpërblyese dhe DPB ka refuzuar nëpërmjet telefonit dhe jo me anë të një shkresë zyrtare. Autoriteti kompetent për dhënien e lejes shpërblyese është drejtuesi i institucionit dhe DPB ka si detyrë

9. Vendimi Nr. 1/154 Akti Datë 10.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;

planifikimin e lejeve¹⁰. Një problem tjetër i konstatuar paraqitet mos dhënia e lejeve shpërblyese personave me shtetësi të huaj. Ky është një problem që duhet të gjejë rregullim, jo diskriminues në legjislacion.

Procedura e shpërblimit të punës së kryer nga të burgosurit vijon të mbetet jo në përputhje me ligjin në fuqi, i cili shprehet se puna e kryer duhet të shpërblehet. Ndërkohë nga monitorimi ka rezultuar se ende vazhdon të aplikohet, kryesisht, ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj dhe dhënia e përfitimit monetar, në masë minimale, që depozitohej në llogarinë bankare të personit. Ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të garantuar të drejtën për punësim dhe për shpërblim të drejtë të punës, për të burgosurit, sipas standardeve ligjore në fuqi.

Ambientet e qëndrimit të personave me **çrregullime të shëndetit mendor** janë përgjithësisht në kushte jo të mira. Pjesën më të madhe të kohës këta persona e kalojnë në dhomë duke mos marrë pjesë në aktivitete rikrijuese. Në mjaft raste, persona të axhituar apo vulnerabël, që i përkasin këtij grupi, vendosen në dhoma me persona të cilët gëzojnë shëndet të plotë, duke krijuar rrezik të mundshëm për keqtrajtim të tyre. Mjetet e shtrëngimit fizik shpeshherë mungojnë dhe për pasojë përdoret vetëm qetësimi me medikamente. Personat ndaj të cilëve është dhënë masë mjekësore “Mjekim i Detyruar”, vazhdojnë të qëndrojnë në mënyrë të padrejtë, kryesisht, pranë IVSHB Tiranë dhe në IEVP Krujë. Numri i tyre është rritur në 164, sepse prokurorët i dërgojnë për të zbatuar masën mjekësore në burg dhe jo në institucione shëndetësore, siç përcaktohet në ligj. Deri më tani KShH ka pasur letërkëmbim zyrtar me instancat më të larta të shtetit, për t’u përpjekur për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme për këtë grup individësh.

E drejta për jetë familjare ka rezultuar se është cënuar në IEVP Fier. Dhomat e takimeve janë të pajisura me xham ndarës dhe disa prej telefonave nuk janë funksionale. Për pasojë, të burgosurit kanë pasur probleme me dëgjimin dhe komunikimin me familjarët e tyre.

10. Referuar Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr.103, datë 14.02.2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçantë të personave të dënuar me burgim” rezultojnë se drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e lejeve shpërblyese në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe të ulët. Pasi përfundon procedura ligjore lidhur me shqyrtimin e kërkesës, drejtori i IEVP-së me shkresë të veçantë njofton drejtorin e përgjithshëm, i cili vendos për planifikimin e lejes.

3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR SITUATËN NË SPITALET PSIKIATRIKE

Në përgjithësi, rezultoi se ambientet spitalore të specializuar me shtretër akomodojnë pacientë brenda kapaciteteve të tyre ligjore dhe në kushte përgjithësisht të mira. Pacientët në momentin e pranimit në institucion i nënshtroheshin ekzaminimeve mjekësore konform protokolleve mjekësore të miratuara. Ushqimi ishte i larmishëm dhe i shumëllojshëm duke ofruar produkte të stinës. Vakti për personat diabetikë ose për ata të cilët mjeku kishte urdhëruar një dietë të veçantë, ofrohej më vite nga ushqimi i përgjithshëm, i cili rezultoi të ishte në kushtet e duhura higjienike. Marrëdhëniet pacient-staf rezultuan përgjithësisht të mira. Stafi mjekësor rezultoi me eksperiencë, të kualifikuar dhe me qasje pozitive ndaj pacientëve.

Spitalet psikiatrike, që ishin rikonstruktuar/ndërtuar vitet e fundit (SP Tiranë, SP Shkodër dhe një pjesë e SP Vlorë), kishin standarde të mira akomodimi të pacientëve. Përgjithësisht në to dhomat ishin me hapësira të mjaftueshme, dritë natyrale dhe me ajrosje. Nëpër dhoma qëndronin nga 1 deri në 3 persona. Në shumicën e rasteve, dhomat e pacientëve ishin të pajisura me televizorë, dollapë personale dhe tavolina, si dhe ishin të lyera, të mirëmbajtura e të pastra higjienikisht. Secili pacient kishte shtrojet e veta personale, të cilat pastroheshin periodikisht në lavanderinë e institucioneve.

Spitali Psikiatrik i Vlorës është i vetmi institucion që ka regjistrat e kufizimit fizik dhe të trajtimit të pavullnetshëm dhe dhomë të kufizimit fizik me standardet e duhura ligjor¹¹. Për të garantuar zbatimin e procedurave korrekte në vitin 2013 është miratuar Protokoli i Kufizimit Fizik nga MSH, bazuar në standardet ndërkombëtare.

11. Në pavionin e urgjencës në Spitalin Psikiatrik në Tiranë dispononin një rregjister të kufizimit fizik në mungesë të rregjistrave standard nga MSH. Nga komunikimet zyrtare me Ministrinë e Shëndetësisë, rezultoi se këto rregjisra janë prodhuar nga QSUT në Nëntor të vitit 2015 dhe Shërbimi i Psikiatrisë është pajisur me rregjistrat standard më datë 01.03.2016. Sa i takon dhomës së kufizimit fizik QSUT i është drejtuar me shprehje zyrtare Ministrisë së Shëndetësisë për alokimin e buxhetit për investime për QSUT përfshirë dhe dhomat për kufizimin fizik;

Gjatë monitorimeve ka rezultuar se përveç Spitalit Psikiatrik (SP) të Elbasanit kapaciteti ligjor i të cilit është 310 shtretër por ditën e monitorimit u gjendën të akomoduar rreth 340 pacientë, në spitalet e tjera psikiatrike të monitoruara u konstatua se akomodoreshin pacientë brenda kapacitetit ligjor. Në të katërt spitalet e monitoruara (Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan) gjendeshin rreth 576 pacientë të hospitalizuar.

Pacienti merrte dijeni verbalisht dhe në mënyrë shkresore për të drejtat e tij, diagnozën dhe trajtimin mjekësor që do t'i nënshtrohej. Personat që i nënshtroreshin trajtimit të vullnetshëm firmosnin në deklaratën e pranimit në dosjen mjekësore. Në SP të Shkodrës u konstatua mungesë personeli mjekësor, e për pasojë nuk respektohej procedura ligjore me tre firma mjekësh, për vendosjen e personave në trajtim të pavullnetshëm.

Sa i takon kushteve infrastrukturore, në SP e Elbasanit dhe një seksioni ende të parikonstruktuar në SP Vlorë kanë nevojë të menjëhershme për ndërhyrje. Në përgjithësi, dhomat e banimit kishin dritë natyrale të mjaftueshme, ishin të higjienizuara dhe pa lagështirë. Pacientët kishin pajisjet për mbajtjen e sendeve të tyre personale. Në institucionet e rikonstruktura kishte dhoma dyshe apo treshe, kurse në SP Elbasan apo në pavionin e pacientëve kronikëve në Vlorë dhomat ishin në formë kapanonesh, të pajisur vetëm me krevate për pacientët me kapacitet nga 10 deri në 13 pacientë në një dhomë, por në godinën e re të spitalit gjendja ishte përmirësuar ndjeshëm.

Problematiche paraqitej mbajtja e personave që vuajnë nga prapambetje mendore në ambientet e specializuar me shtretër në këto spitale. Kjo kategori individësh nuk duhet të qëndrojë në spitalet psikiatrike, për arsye se nuk kanë nevojë për trajtim medikamentoz në kushte spitalore. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë duhet të marrin masa për zgjidhjen e situatës.

Përgjithësisht ushqimi ofrohej nga firma kontraktore dhe përgatitej në institucion. Për personat që nevojitej ushqim i posaçëm për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore ofrohej me vete në kushte të përshtatshme higjienike.

Aktivitetet rehabilituese realizoheshin më së shumti me pacientët që ishin në gjendje t'i ndiqnin ato, kryesisht në SP të rikonstruktura, të tilla si lojëra me top, lojëra formuese, shëtitje në qytet, në plazh rrallëherë, ndjekja e programeve televizive, lojëra tavoline, leximi i librave të ndryshëm, etj... Ndërsa në SP të Elbasanit vetëm një numër i limituar pacientësh angazhoheshin në aktivitete rehabilituese. Në shtëpitë mbështetëse vajzat dhe gratë merreshin më së shumti me kujdesin për higjienën personale, terapi okupacionale, gatim, etj... Në këtë drejtim institucioni i

Vlorës ofronte programe të plota për shkak të infrastrukturës së re e cila ia lehtësonte kryerjen e aktiviteteve të tilla ditore.

Vëzhguesit e KShH-së nuk morën ankesa nga pacientët për sjellje jo të mira/keqtrajtime nga stafi ndaj pacientëve, as u vunë re pacientë me shenja dhune të dukshme. Vihej re përkujdesje ndaj pacientëve e përkushtim për punën nga personeli mjekësor. Një grup i madh pacientësh nuk kanë marrëdhënie me familjarët e tyre, sidomos ata që gjendeshin në institucion për kohë të gjatë. Një pjesë e tyre ishin lënë prej vitesh në harresë prej të afërmeve të tyre. Madje këta të fundit, në disa raste përfitojnë padrejtësisht pagesat e KEMP-it të pacientëve.

Kufizimi fizik ndaj pacientëve të axhituar, realizohej sipas standardeve vetëm në SP të Vlorës. Dhoma e kufizimit fizik në këtë institucion përmbushte standardet e kërkuara dhe monitorohej elektronikisht. Masat e kufizimit fizik shënoheshin në regjistrin e kufizimit fizik, regjistër i cili mungonte në institucionet e tjera.

Procedura për vendosjen e një personi në trajtim të pavullnetshëm jo gjithmonë respektohej konform ligjit. Një pjesë e personelit mjekësor nuk kishin njohuri të thelluara për procedurat ligjore të trajtimit të pavullnetshëm, të mjekimit të detyruar apo shtrimit të përkohshëm. U konstatua mungesë dokumentacioni në dosjet mjekësore të pacientëve që ishin në trajtim të pavullnetshëm. U verifikuan raste kur në seancën gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës së institucionit për trajtim të pavullnetshëm nuk paraqitej juristi i institucionit, por mjeku psikiatër ose punonjësja sociale. Masa mjekësore “Mjekim i detyruar” dhënë nga gjykata, jo gjithmonë rishikohej çdo një vit me iniciativën e gjykatës, siç parashikon neni 46 i Kodit Penal. Në vendimet gjyqësore vihet re një praktikë e gabuar e përdorimit të termave si “*mjekim i detyruar*” ose “*shtrim i detyruar*” kur jepet vendimi për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e personit në trajtim të pavullnetshëm. U referua tejkallim i afateve ligjore për më shumë sesa një javë në shumë prej rasteve që paraqiten në gjykatë.

METODOLOGJIA E VËZHGIMEVE

Në kuadër të projektit “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, i cili zbatohet nga KShH dhe mbështetjen financiare nga Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë Suedeze, si dhe në kuadër të projektit “Së bashku kundër torturës në polici dhe në burgje në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian, gjatë periudhës Korrik 2015 –Janar 2016, janë realizuar në total 45 vizita monitoruese në institucionet policore, ato të ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalet psikiatrike.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 19¹² vizita monitoruese në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale konkretisht: IP Elbasan, IVM Kavajë, IEVP Fier, IVSHB, IEVP Ali Demi, IEVP Vaqarr, IP Durrës, IEVP Burrel, IEVP Kukës, IEVP Krujë, IEVP Fushë –Krujë, IEVP Korçë, IEVP Lezhë, IEVP Tepelenë dhe IP Sarandë.

Janë realizuar 22 vizita monitoruese në komisariate e stacione policore, konkretisht në: Komisaritet e Policisë Delvinë, Sarandë, Gjirokastrë, Berat, Korçë, Tepelenë, Devollë, Maliq, Lezhë, Kukës, Burrel, Dibër, Tiranë (6 komisaritet), Krujë dhe Durrës.

Janë monitoruar 4 Spitale Psikiatrike: Spitali Psikiatrik Vlorë “Ali Mihali”, Shërbimi i Shëndetit Mendor i Specializuar me shtretër në Shkodër, Spitali Universitar Psikiatrik “Xhavit Gjata” dhe Spitali Psikiatrik në Elbasan “Sadik Dinçi”, dhe disa nga shtëpitë e mbështetura në këto rrethe.

Qëllimi kryesor i vizitave monitoruese është vëzhgimi i respektimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese, konventore dhe ligjore të sanksionuara për personat me liri të kufizuar, që ndodhen pranë institucioneve të sipërshtuara. Vëmendje të veçantë gjatë këtyre monitorimeve i është dhënë respektimit të të drejtave dhe trajtimi i duhur i personave në pozita të dobëta në këto institucione¹³. Vizitat monitoruese janë udhëhequr nga parimet e përgjithshme të së drejtës, standardet ndërkombëtare, legjislacioni shqiptar si dhe rekomandimet e organizmave që veprojnë në këtë fushë.

12. Janë monitoruar 15 institucione, disa prej tyre janë monitoruar më shumë se një herë;

13. Persona në pozita të dobëta janë të miturit, gratë, personat LGBTI, të sëmurët mendorë, të moshuarit, etj..

Konkretisht, listojmë si më poshtë aktet bazë që janë mbajtur në konsideratë gjatë monitorimeve:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
3. Direktivat e Bashkimit Evropian, Rekomandimet për Shqipërinë;
4. Kodi Penal;
5. Kodi i Procedurës Penale;
6. Ligji nr. 9331, dt.21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr.10024, dt.27.11.2009 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”
7. Ligji Nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”;
8. Ligji nr.9888, dt.10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8328, dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”
9. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”
10. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve;
11. Rregullorja e Policisë së Shtetit;
12. Manuali “Për rregullat dhe procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar, në Njësitë Policore”;
13. Rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Avokatit të Popullit dhe KShH;
14. Protokolli i Kufizimit Fizik i vitit 2013;

Për realizimin e misioneve të vëzhgimit, janë angazhuar vëzhgues me përvojë shumë vjeçare dhe me profesione të ndryshme, në përputhje me kërkesat profesionale të monitorimit, të tillë si: juristë, psikologë, punonjës socialë, si dhe mjekë psikiatër dhe të specialiteteve të tjera. Grupet e vëzhgimit janë përbërë nga dy ose tre vëzhgues të profesioneve të ndryshme. Disa prej vizitave monitoruese janë realizuar në bashkëpunim me Mekanizmin për Parandalimin e Torturës, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Në përmbushje të misionit dhe objektivave konkrete të monitorimeve, KShH, paraprakisht dhe në vijimësi, ka trajnuar grupin e vëzhguesve për metodologjinë e vëzhgimeve, çështje të përditësuara nga situata aktuale e institucioneve të policisë dhe burgjeve, si në planin teorik dhe në atë praktik. Parandalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe keqtrajtimit në vendet e privimit të lirisë, parë nën dritën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ishte një tjetër këndvështrim i aftësimit të vëzhguesve të KShH-së, për t’u mbajtur parasysh gjatë kryerjes së vëzhgimeve.

Ekspertët e KShH-së hartuan pyetësorë të detajuar të cilët shërbyen për strukturimin e vëzhgimit, si dhe për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit në përputhje me qëllimin e vëzhgimeve, duke lënë hapësirë edhe për monitorimin e çështjeve të tjera me rëndësi.

Gjatë vëzhgimeve grupet e monitorimit, pasi janë prezantuar në institucionet përkatëse, kanë marrë takim me drejtuesit e tyre dhe më tej, kanë realizuar vizitat monitoruese në regjimet e brendshme dhe të jashtme të institucioneve. Një pjesë e rëndësishme e vëzhgimit ka qenë zhvillimi i një numri të konsiderueshëm intervistash me të shoqëruarit/ ndaluarit/arrestuarit, të paraburgosurit/të dënuarit dhe pacientët psikiatrik. Pjesë e vëzhgimeve ka qenë edhe këqyrja dhe konsultimi i dokumentacionit përkatës në institucionet e vëzhguara.

Në përfundim, grupet monitoruese, u kanë bërë prezent drejtuesve të institucioneve, gjetjet më të rëndësishme që kanë dalë nga vëzhgimi konkret. Kur është vlerësuar se ka qenë e nevojshme marrja e masave urgjente në nivel qëndror për përmirësimin e problemeve të konstatuara, KShH i është drejtuar me korrespondencë zyrtare drejtuesve të lartë të DPB-së, DPSH-së, Ministrisë të Drejtësisë dhe asaj të Punëve të Brendshme.

Vlen të theksohet se KShH, për çështje të tilla si marrja e masave për zvogëlimin e mbipopullimit në sistemin e burgjeve dhe mbajtja e personave me masë mjekësore “Mjekim të detyruar” në institucione penale në shkelje flagrante të standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas, i është drejtuar me korrespondencë zyrtare instancave më të larta shtetërore si Presidentit të RSH-së, Kryetarit të Kuvendit të RSH, Kryeministrit, Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Komisioneve relevante të Kuvendit të RSH, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë etj... Për pasojë, një grup deputetësh morën iniciativën e realizimit të një monitorimi të përbashkët me KShH në institucionin penitenciar të Zahari, Krujë, nga ku rikonfirmuan edhe një herë gjetjet e monitorimit të mëparshëm të realizuar nga KShH, si dhe nevojën për ndërhyrje të menjëhershme për përmirësim të situatës në këtë institucion.

Një rëndësi të veçantë gjatë kryerjes së vëzhgimeve iu është kushtuar trajtimit të grupeve në pozita të dobëta, që mbahen në komisariatet e policisë apo institucionet penitenciare. Trajtimi i diferencuar që iu duhet ofruar këtyre grupeve me nevoja specifike trajtimi, buron nga ligji dhe reflekton kujdesin e shtuar që duhet të kenë strukturat policore dhe ato të burgjeve në raport me këta persona.

Ky raport përmbledh gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet e vizitave monitoruese, parë nën një këndvështrim objektiv dhe të paanshëm, të udhëhequr nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me strukturat e monitoruara, në respekt të plotë të punës së vështirë dhe dinamike që realizojnë administrata e Policisë së Shtetit dhe ajo e burgjeve.

KREU 1. SITUATA NË KOMISARIATET E POLICISË

1. GJETJE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONET E POLICISË

1.1 E DREJTA PËR TRAJTIM DINJITIZ

1.1.1 TORTURA DHE KEQTRAJTIMI

Tortura, trajtimi çnjerëzor e degradues është parashkruar si vepër penale me rrezikshmëri mjaft të lartë shoqërore në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën “Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese”, “Konventën Evropian për të Drejtat e Njeriut, etj... Nëpërmjet ratifikimit të këtyre akteve ndërkombëtare ajo angazhohet të marrë të gjitha masat për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimeve a dënimeve mizore e poshtëruese, si dhe ndëshkimin e shkelësve në rast se konstatohet kryerja e kësaj vepre penale.

Sipas nenit 10 të Konventës “Kundër Torturës dhe Trajtimeve a dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese” (në vazhdimësi Konventa) sanksionohet se: “Çdo shtet palë siguron që arsimi dhe informacioni në lidhje me ndalimin e torturës të jenë pjesë përbërëse e trajnimit të personelit civil ose ushtarak të ngarkuar për zbatimin e ligjeve, të personelit mjekësor, të personave zyrtarë dhe të personave të tjerë të cilët mund të marrin pjesë në ruajtjen, marrjen në pyetje ose trajtimin e çdo individi të paraburgosur, të privuar nga liria ose të burgosur në çfarëdo mënyre.

Gjatë monitorimeve, në Komisariatit e Korçës një prej personave të arrestuar pretendoi se ishte transportuar, nga vendi i ngjarjes deri në Komisariatit e Korçës, në bagazhin e makinës, model Jeep në administrim

nga institucioni policore, udhëtim që ka zgjatur mbi 2 orë. Nga takimi i marrë me të, ai pretendoi se, i vendosur për t'u transportuar në pjesën e mbrapa të makinës (bagazh) , duart i kishte patur të lidhura me pranga dhe për shkak të situatës kishte ndjerë marrje fryme dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore.

Situata u paraqit e pandryshuar në Komisaratin e Sarandës, krahasuar me gjetjet e një viti më parë. U konstatua një person i shoqëruar, i cili pretendonte se ishte goditur me shuplakë gjatë transportimit për në komisarati. Gjithashtu, gjatë monitorimit në IEVP Sarandë¹⁴, nga personat e sistemuar atje u pretendua se dëgjoheshin 'ulërima' të personave që keqtrajtoheshin, të cilat vinin nga komisarati dhe se në disa raste keqtrajtoheshin edhe persona të cilët kishin çrregullime mendore. Në IEVP Sarandë, nga një shtetas i paraburgosur na u referua se ndaj një të paraburgosuri tjetër, me probleme të shëndetit mendor, ishte ushtruar dhunë fizike, duke u goditur në kokë, nga punonjësit e policisë të Komisaratis të Sarandës. Personi që pretendohet se qe dhunuar nuk ndodhej më në institucion, por pati pretendime nga të paraburgosurit e tjerë se, kishte mbërritur me shenja dhune në gjymtyrët e sipërme. Drejtuesi i institucionit kishte mundur realizimin e një ekzaminimi "ezhe" në spitalin e qytetit për të, por analizat kishin rezultuar negative.

Nga monitorimi në IVM Kavajë, pati pretendime për dhunë, të pësuar gjatë kohës që ata kishin qëndruar në Komisaratin Nr. 5 Tiranë dhe Komisaratin e Elbasanit, nga të miturit e dënuar. Në Komisaratin e Korçës, gjithashtu, u ngritën pretendime për goditje nga punonjësit e policisë me shuplaka në fytyrë dhe grushte në bark, gjatë kohës së arrestimit në flagrancë, si dhe gjatë procedurës së marrjes në pyetje të të arrestuarve.

Konventa sanksionon se "Çdo shtet palë ushtron një mbikëqyrje sistematike të rregullave, udhëzimeve, metodave dhe praktikave të pyetjes dhe të dispozitave lidhur me ruajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar, të privuar nga liria ose të burgosur në çfarëdo mënyre në çdo pikë të territorit nën juridiksionin e tij, me qëllim që të mënjanojë çdo rast i torturës".¹⁵

Për më tepër ushtrimi i dhunës ndaj shtetasve gjatë procedurës së marrjes në pyetje, gjatë arrestimit, transportimit, etj.. në disa raste

14. IEVP Sarandë dhe Kom. Sarandë janë të vendosura në të njëjtën godinë, por me hyrje të ndryshme;

15. Konventa "Kundër Torturës dhe Trajtimeve a dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese", Neni 11;

përmban elemente të veprës penale të “Torturës”¹⁶ dhe jo veprës penale të “Veprimeve Arbitrare”¹⁷, sikurse është cilësuar nga organet e procedimit. KShH ha hartuar dhe publikuar një studim unik në Shqipëri, pikërisht për të adresuar problemet që lidhen me këtë vepër penale, të cilin mund ta gjeni në adresën zyrtare dhe në versionin on line në faqen e internetit të KShH.

I njëjti qëndrim rezulton edhe në raportin vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm referuar vitit 2013 ku shprehet se ka kërkuar nga trupa e prokurorëve të rretheve gjyqësore, një rol më aktiv në respektim të të drejtave të njeriut dhe konkretisht: *“Kur gjatë hetimeve paraprahe apo gjatë gjykimit, pretendohet dhunë e ushtruar nga funksionarët publikë apo konstatohen shenja të dukshme dhune, prokurori duhet të marrë masat për kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe të iniciojë fillimin e procedimit penal; Të bëhet kujdes në kualifikimin e drejtë të veprave penale të parashikuara nga neni 86 i K.P “Tortura” dhe Neni 250 i K.P “Veprime arbitrare. Të rritet bashkëpunimi me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, me qëllim evidentimin e këtyre rasteve.”*¹⁸

1.1.2 PËRDORIMI I FORCËS

Të jesh pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit është një punë që mbart vështirësi dhe sfida, si dhe kërkon profesionalizëm, e përkushtim të vazhdueshëm. Gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, punonjësi i policisë ka të legjitimuar përdorimin e forcës proporcionale, kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme, apo të pamundura. **Forca përdoret në përputhje me parimin e proporcionalitetit.**¹⁹ Punonjësi i policisë **përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, por**

16 **Kodi Penal, Neni 86** “Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim:

a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime; b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër; c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër; ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi; d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues; - dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”

17. **Kodi Penal, Neni 250:** “Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

18. Raporti Vjetor 2013 i Prokurorit të Përgjithshëm, Fq. 15; http://www.pp.gov.al/web/raporti_2013_855.pdf

19. Ky parimi për vet rëndësinë që mbart është parashikuar në mënyrë eksplicite si një ndër parimet kryesore që duhet të udhëhiqet puna e Policisë së Shtetit dhe konkretisht në Nenin 5;

gjithmonë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. **Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.**²⁰

KShH vlerëson nxjerrjen e Urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit Nr. 678, datë 14.09.2015, nëpërmjet të cilit është miratuar Procedura Standarde e Punës, “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Personat të cilët shoqëroheshin në komisariat firmosnin një dokument, në formë formulari, ku ndër të tjera shënohet nëse ndaj personave të shoqëruar ishte ushtruar dhunë nga punonjësve të policisë, ose ndonjë koment tjetër shtesë lidhur me këtë aspekt. Ky formular plotësohet në dy kopje, një prej të cilëve e mbante vetë personi dhe kopja tjetër mbahej nga komisariati. Kjo praktikë u verifikua në Komisaratin e Beratit dhe të Korçës. Në Komisaratin e Beratit, gjithashtu, mbahej edhe një regjistër ku vërtetohej se këto fletë shoqërimi ishin dorëzuar në Sekretarinë e Komisarimit. Shpresojmë që nëpërmjet zbatimit të këtij akti nënligjor, do të përmirësohet respektimi i të drejtave të shtetasve nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Në Komisaratin Nr. 6 në Tiranë rezultoi se zbatoheshin një praktikë e tillë, ku drejtuesi i institucionit telefononte personat të cilëve komisariati i kishte ofruar shërbime (p.sh. persona të cilët kishin kallëzuar) gjatë një periudhe kohore të caktuar. Lista e numrave të kontaktit me të dhënat përkatëse si gjeneralitetet dhe shërbimi përkatës i ofruar përgatitej nga personeli përkatës i institucionit. Numrat e kontaktit zgjidheshin në mënyrë të rastësishme. Kishte rezultuar se në pjesën më të madhe të rasteve vlerësimi i qytetarëve ishte pozitiv.

KShH ka trajtuar një rast gjatë vitit 2015, ku është ushtruar dhunë ndaj një të riu 18 vjeç në momentin e arrestimit të tij nga disa punonjës policie pa uniformë. Shenjat e dhunës u konfirmuan edhe nga ekspertiza mjekoligjore e realizuar, pasi çështja u denoncua dhe u procedua në gjykatë.

1.1.3 PROCEDURA E MARRJES NË PYETJE

Procedura e marrjes në pyetje është një moment i rëndësishëm proceduralo-penal. Nga monitorimet ka rezultuar se përgjithësisht ndiqen procedurat ligjore, por u konstatuan raste kur kjo procedurë nuk kryhej në respekt të këtyre rregullave. **Legjislacioni penal parashikon se nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda**

20. Referuar Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Neni 133;

ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve. “Para se të ketë filluar pyetja, të pandehurit i shpjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet, procedimi do të vazhdojë”²¹.

Siç u përmend më lart, janë evidentuar raste ku ndaj personave të arrestuar ose të ndaluar është pretenduar se është ushtruar dhunë, me qëllim marrjen e informacionit. Përmendim se gjatë monitorimit, që KSHH ka realizuar në IVM Kavajë, u intervistuan disa të mitur, ndër të cilët, njëri pretendonte se ishte goditur nga punonjësit e policisë gjatë procedurës së marrjes në pyetje në komisariatit e Elbasanit, ndërkohë që duart i kishte të lidhura pas kurrizit. I mituri pretendoi se ishte dhunuar në komisariat dhe pasi punonjësit kishin marrë dijeni se personi ishte i mitur, kishin ndaluar ushtrimin e dhunës.

Garanci për reduktimin e të tilla formave të paligjshme të kryerjes së detyrës do të ishte regjistrimi audio-video i kësaj procedure, sikurse ishte vendosur, së fundmi ,në Komisaratin e Durrësit. Sipas standardeve të KPT²² dhe rekomandimeve të vazhdueshme të organizmave monitorues, regjistrimi elektronik jo vetëm shmang keqtrajtimet, por ka avantazhe dhe për punën e policisë. Në komunikimet zyrtare me DPSH, KShH është vënë në dijeni se realizimi i investimeve në këtë drejtim do të kryhet njëherazi me investimet që do të realizohen për rikonstruksionin dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme në ato njësi policore që nuk kanë përfituar investime të tilla.

Sa i takon marrjes në pyetje të personave të mitur një rol, mjaft të rëndësishëm, luan prezenca e detyrueshme e psikologut. Nga vëzhgimi rezultoi se në strukturat e drejtorive vendore të policisë, pozicioni i punës i psikologut ishte i shkrirë me atë të juristit të institucionit. Kodi i Procedurës Penale, shprehet qartë dhe në mënyrë eksplicite se, në rast të një procesi penal ku autori i dyshuar i veprës penale është i mituri, duhet siguruar patjetër prezenca e një psikologut, gjatë marrjes në pyetje.

Nga monitorimet e realizuara është konstatuar se në shumicën e rasteve nuk ka një dhomë të posaçme për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, por zakonisht personat pyeteshin në zyrat e punonjësve të policisë. Përgjithësisht personat e ndaluar/arrestuar pyeteshin gjatë ditës, por nuk mungonin rastet e marrjes në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve gjatë orëve të natës, për disa orë me radhë.

21. Referuar Kodit Penal, Neni 38;

22. Referuar Standardeve të Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimet e Dënimit Çnjerëzor e Degradues 2015, Fq.7 Pika39/2; <http://www.cpt.coe.int/en/documents/eng-standards.pdf>

Një element tjetër i rëndësishëm lidhet me afatin e qëndrimit të personave të shoqëruar në ambientet policore. Referuar Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”²³ konkretisht në Nenin 109, rezulton se afati i shoqërimit për arsyet e parashikuara në ligj është jo më shumë se 10 orë. U gjet një rast i tejkalimit të afatit të shoqërimit si në Komisarlatin e Tepelenës, ku nga këqyrja e regjistrave u pa se një person i shoqëruar rezultonte të ishte mbajtur 12 orë në komisarlat.

1.1.4 E DREJTA PËR KËRKESË-ANKESË

E drejta për të drejtuar një kërkesë ose një ankesë është parashikuar shprehimisht në Nenin 115 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”. *“Çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cënohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t’u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore.....”*

Nga monitorimet ka rezultuar se pjesa më e madhe e kërkesave ose e ankesave i drejtoheshin në mënyrë verbale punonjësit të dhomave të sigurisë dhe tentohej t’i jepej zgjidhej në mënyrë të shpejtë. Kërkesë-ankesat konsistonin më së shumti në takime me familjarët ose me avokatin. U konstatua një rast ku komisarlati i policisë nuk kishte efektivisht një regjistër të kërkesë ankesave dhe përmendim këtu Komisarlatin Nr.4 Tiranë. Kur kishte ankesa, ato shënoheshin në regjistrin e hyrjeve-daljeve. Në Komisarlatin Nr. 2 Tiranë u vu re se regjistri i kërkesë ankesave ishte bosh.

Nga intervistimi i personave të shoqëruar na u tha prej tyre se kërkesat e tyre ishin plotësuar pa vonesa dhe në këtë drejtim nuk kishin ankesa. Por, në rastet e pretenduara për keqtrajtim nga punonjësit e policisë, personat kanë preferuar të mos drejtojnë një ankesë më shkrim, pasi mendojnë që kjo mund të rëndojë situatën e tyre procedurale. Kjo shpreh një mungesë besimi të theksuar në strukturat policore, të cilat duhet të ndërmarrin hapat e duhura dhe për të rritur besimin e qytetarëve për të reaguar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre.

23. http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents_files/LIGJI_I_POLICISE_SE_SHTETIT_-_2014.pdf

1.1.5 PROCEDURA E TRANSFERIMIT

Në legjislacionin procedural penal në fuqi, parashikohet se kur nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, prokurori, brenda **dyzet e tetë orëve** nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbas fuqinë. Gjykata cakton seancën e vleftësimit sa më shpejt duke lajmëruar prokurorin dhe mbrojtësin. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur **brenda dyzet e tetë orëve** të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë.²⁴

Nga monitorimet ka rezultuar se, përgjithësisht, personat qëndrojnë brenda afateve ligjore në ambientet e komisariateve. Ende ka problematikë në rastin e transferimit për në IEVP-të ku do të vuajnë dënimin me burg, ose masën e sigurimit personal “Arrest me burg”. Për zgjidhjen e këtij problemi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 2157\1, datë 17.03.2015 *“Për rritjen e sigurisë në IEVP, sigurimin e të burgosurve dhe p/burgosurve që trajtohen me leje, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale”*.

Në këtë drejtim u konstatuan shkelje në Komisariatit Nr.1 Tiranë, Komisariatit. Nr. 2 Tiranë, dhe Komisariatit Nr. 3 Tiranë. Një marrëdhënie e mirë në zbatimin e këtyre procedurave u vërejt në Komisariatit e Dibrës. Në Kom. Nr. 1 Tiranë u konstatua se ndaj një personi që ishte dhënë kjo masa e sigurimit me burg më datë 27.09.2015, në datë 30.09.2015 ai ishte ende në ambientet e komisarariatit. Në Kom. Nr. 2 Tiranë, një person i cili ishte dënuar në mungesë, ishte arrestuar më datë 16.09.2015 dhe qëndronte ende në ambientet e komisarariatit për rreth 13 ditësh. Në Kom. Nr.3 Tiranë u konstatua i njëjti rast ku vonesa e transferimit vazhdonte prej 5 ditësh. Sa më sipër rezulton se janë shkelur afatet ligjore, pasi me marrjen e vendimit të formës së prerë, këta persona duhet të dërgohen menjëherë në ambientet e vuajtjes së dënimit, ose mjediset e paraburgimit dhe e njëjta gjë vlen për personat të cilët janë dënuar në mungesë. Autoritetet e policisë prezantuan si shkak të këtyre vonesave mbipopullimin e burgjeve dhe paraburgimeve që janë në vartësi të DPB.

24. Referuar Kodit të Proedurës Penale, Neni 258 dhe 259;

1.1.6 KUSHTET INFRASTRUKTURORE

Sikurse sanksionohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe **qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik**. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.²⁵ Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shteti” në Nenin 2 shprehet se: “Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike....garantimin e zbatimit të ligjit, **në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare**, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”.

Sipas Manualit “Për rregullat dhe procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar, në Njësitë Policore²⁶”, të ndaluarve dhe të arrestuarve u krijohen kushte jetese të përafërta me ato të jetës së shtetasve të tjerë të lirë. Nga monitorimi u konstatua se në disa prej komisariateve të rikonstruktuar rishtazi, në dhomat për një person, gjendej më shumë se një i/e ndaluar/arrestuar, për shkak të mbipopullimit. Për pasojë të ndaluarit/arrestuar, në disa raste, flinin në dysheme **në mungesë të shtretërve**. Situatë e tillë u gjet në Komisaritet Nr. 1, 2, 3 dhe 5 në Tiranë, në Komisariatin Korçë dhe Krujë.

Sipas standardeve të përcaktuar nga KPT²⁷, parametrat e dëshirueshme²⁸ për një person që qëndron në një dhomë të ndalimit policor, për disa orë, sipërfaqja e mjedisit duhet të jetë rreth 7 metra², me distancë ndërmjet mureve 2 metra, ose më shumë dhe ndërmjet dyshemesë dhe tavanit 2.5 metra. Në mjaft raste **dhomat e sigurisë** dhe të shoqërimit nuk i plotësonin standardet ligjore të hapësirës për person. U evidentua një rast ku dhoma ishte pothuaj 4m² dhe ku ishin vendosur në dysheme 2 dyshekë, të cilët shërbenin për të fjetur personat e ndaluar apo të arrestuar, duke zënë kështu të gjithë sipërfaqen e dhomës (konstatuar në Komisariatin Nr.1 Tiranë, Komisariatin Korçë). Në Komisariatin e Korçës u konstatua se një person flinte me kokën pranë derës së tualetit, për shkak të hapësirës të pamjaftueshme në dhomë për dy persona.

25. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 15;

http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta_perditesuar_15171_1.pdf

26. Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.763, datë 27.09.2011;

27. Komiteti për Parandalimin e Torturës është organ i Këshillit të Europës, i krijuar për monitorimin e të drejtave të parashikuara në “Konventën për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues” më 1987 . Ky organ monitoron vendet e privimit të lirisë në shtet që janë antare në Këshillin e Europës.

28. Referuar standardeve të KPT, Pika 43, Fq.8, <http://www.cpt.coe.int/en/documents/eng-standards.pdf>

Në Komisarlatin e Sarandës mungonin dhomat e posaçme të shoqërimit. Në Komisarlatin Nr. 6 Tiranë në rastet kur kryhen veprime verifikuese me të shoqëruarit, ato mbahen në zyrat e administratës ose në korridorin e dhomave të sigurisë. Në Komisarlatin e Burrelit u verifikua një dhomë që përdorej për intervistimin e personave të shoqëruar, e cila nuk kishte dritare, orënditë e nevojshme, ndërsa mbyllej me një derë hekuri.²⁹

Pjesa më e madhe e komisarlateve të monitoruara nuk dispononin një dhomë të posaçme për të miturit, ose një dhomë për personat e gjinisë femërore. Në disa raste kishte vetëm një dhomë për të dy këto kategori dhe në disa raste nuk kishin asnjë dhomë të tillë.

Ndërkohë, në pjesën më të madhe të institucioneve të monitoruara, na rezultoi se **kushtet e jetesës në dhoma ku mbaheshin shtetasit e kufizuar nga liria** nuk kishin kushte të mira. Ato ishin me prezencë të lagështirës, me suva të dëmtuar, ndriçim jo të mjaftueshëm (Kom. Nr. 4, 5 Tiranë, Kom Krujë, Kom Lezhë, Kom Sarandë, Kom. Dibër, dhe Burrel). Në disa nga institucionet e sipërpërmendura higjiena linte mjaft për të dëshiruar. Në Komisarlatin e Dibrës mungonte sanitarja, si funksion në organikën e institucionit dhe për këtë arsye, ky funksion realizohej nga polici i shërbimit. Komisarlati Nr.6 në Tiranë funksiononte në një godinë mjaft të vjetër, megjithëse në kushte të mira higjienike.

U vu re **mungesë detergjentësh** të cilët janë të rëndësishëm, si për të mbajtur pastër ambientet e përbashkëta, po ashtu për higjienën personale të të shoqëruarve /ndaluarve/ arrestuarve, që gjenden në këto institucione. Shpesh herë këto detergjentë bliheshin nga vet punonjësit e policisë³⁰ (Kom. Nr. 5 Tiranë, Kom Durrës, Kom Korçë, etj.).

Nga monitorimet rezultuan se në disa raste **tualetet ose dushet** linin për të dëshiruar nga pikëpamja e higjienës, mungesës së ndriçimit dhe amortizimit të lartë të pajisjeve të tyre (Komisarlati Nr. 1, 2, 4 dhe 5 Tiranë, Kom Krujë dhe Burrel). Në Manualin e Dhomave të Sigurisë përcaktohet se për efekt të sigurimit e ruajtjes së higjienës e pastërtisë në këtë ambient, disa herë në ditë kryhet pastrimi dhe një herë në ditë klorifikimi i pajisjeve të WC-ve.³¹ Gjendjen e përkeqësonte **mungesa e ujit të rrjedhshëm** në disa komisarlate (Kom. Nr. 4 Tiranë, Kom Lezhë, Kom Kukës) si dhe e **ujit të ngrohtë** (Komisarlati Nr. 1, 2, 5 Tiranë, Kom Krujë).

29. U referua nga personeli së në këtë ambient merreshin në pyetje përsnat që shfaqeshin agresiv;

30. Mjete dhe detergjent si kovë, shtupë, sapunë, etj.

31. Referuar Manualit “Për rregullat dhe procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar, në Njësitë Policore”, Pika3/3.4;

KShH vlerëson mbylljen e disa dhomave të shoqërimit apo ndalimit në disa komisariate policore, por konstaton se vijon të zbatohet e njëjta procedurë, jo konform ligjit, për mënyrën e mbylljes së tyre. Për mbylljen e dhomave duhet të zbatohen procedurat ligjore të përcaktuara, pra më dry, me dyllë e me vulë, te cilat nuk duhet të hapen më deri në përmirësimin e gjendjes (dhoma jashtë përdorimit rezultuan në Kom Nr.1 dhe Nr. 6 Tiranë).

Mungesa e bazës materiale të nevojshme për kryerjen e detyrës nga strukturat policore u ngrit si shqetësim në mjaft raste. Konkretisht u referua për mungesë të pajisjeve të tilla si fotokopje, printer, kompjuter, kancelari, etj... Në Komisaratin e Tepelenës u ngrit shqetësim për mungesën e furnizimit me karburant, pasi kjo ndikonte drejtpërdrejt në punën e tyre të përditshme.

1.2 E DREJTA E NJOFTIMIT TË ARSYES SË SHOQËRIMIT/ NDALIMIT / ARRESTIMIT/ DHE NJOFTIMI I FAMILJARËVE

Çdo individ të cilit i privohet liria, për arsye të parashikuara në ligj, ka të drejtë të informohet mbi arsyet e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, që në momentin e parë të privimit të lirisë. Nëse i referohemi Kodit Procedurës Penal, neni 256 i tij parashikon se: *“Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarin ose të ndaluarit faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet”*. Nga ky parashikim ligjor rezulton se ky është momenti i njoftimit të arsyes të privimit të lirisë. Në nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të njeriut parashikohet se: *“Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën që ai kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet”*. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë shkon edhe më tej, pasi parashikon se çdo personi të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë³²

Përgjithësisht, nga monitorimi ka rezultuar se personat njoftohen për arsyen e privimit të lirisë në momentin e marrjes në pyetje nga OPGJ-të. Në disa raste ka rezultuar se nuk i janë komunikuar të drejtat e tyre që në momentin e parë të izolimit si, në Kom. e Sarandës dhe në Kom. e Kukësit dhe të Korçës. Ndërsa në Kom. e Dibrës nga monitorimi rezultoi

32. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 28;

se personat merrnin dijeni menjëherë për arsyen e privimit të lirisë, si dhe ishin pajisur me kopjen e deklaratës së të drejtave.

*Legjislacioni në fuqi parashikon se të ndaluarit/arrestuari duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit të kontrollit personal dhe **kopje të deklaratës për njohjen me të drejtat e tij**.*³³ Në pjesën më të madhe të institucioneve të monitoruara rezultoi se personat pajiseshin me deklaratën e të drejtave. Megjithatë u vërejt mungesë njoftimi në disa Komisariate të tilla si në Kom. Nr. 1, Kom.Nr.5 dhe Kom. Krujë, Kom. Lezhë se personat nuk ishin të pajisur me kopjen e deklaratës së të drejtave.

KShH, vlerëson pozitivisht faktin se në të gjithë ambiente e policisë të monitoruara ishin afishuar deklarata e të drejtave të personave që mbahen në ato mjedise për arsye të parashikuara nga ligji. Këto të drejta, në formën e tabelave publicitare, ishin afishuar pothuajse në të gjitha ambientet e institucioneve përkatëse, në korridore, në paradhomë dhe në dhomat e sigurisë.

Njoftimi i familjarëve përgjithësisht realizohej nga punonjësit e policisë (zakonisht nga oficeri i informacionit) dhe në mjaft raste me telefonin e tyre personale. Në disa raste rezultoi se familjarët e të mituri njoftoheshin nga vetë OPGJ-të.

1.3 E DREJTA PËR T'U MBROJTUR ME AVOKAT

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në Nenin 28 të saj se: "Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të **drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin**, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij".* Neni 31 zgjeron më tej garancitë duke parashikuar se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor, të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme. Ky parashikim ligjor shkon në të njëjtën linjë me Nenin 6/3/c të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.³⁴

33. Manualit për Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore, Pika 1/1.14;

34. Kodi i Procedurës Penale në Nenin 255/1 parashikon se: "Oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori".

Në Komisariatit Nr. 5 Tiranë u mor kontakt me një person, i cili referoi se gjatë procedurës së marrjes në pyetje kishte kërkuar të përfaqësohej nga një avokat, por kjo nuk i ishte mundur. Në Komisariatit e Lezhës, nga kontakti i marrë me personat e arrestuar, u pretendua se nuk iu është bërë me dije se kanë të drejtë të përfaqësohen me avokat, gjatë procedurës së marrjes në pyetje. Në të njëjtin komisarariat një prej personave të ndaluar, referoi se nuk kishte patur avokat gjatë marrjes në pyetje, por nga procesverbali i marrjes në pyetje rezultoi se ishte pyetur në prani të një avokati, të cilin ai pretendonte se nuk e kish parë e takuar ndonjëherë.

Komisariatet e policisë dhe stacionet policore të gjithë ishin të pajisur me listat e avokatëve nga Dhomat e Avokatisë në rrethe, për të asistuar personat të cilët nuk kishin mundësi të paguanin një avokat privat. Rezultoi një bashkëpunim i mirë me Dhomat e Avokatisë në rrethe për caktimin e avokatëve kryesisht. Në ambientet policore të monitoruara ekzistonin ambiente të posaçme të takimeve me avokatët, të cilat funksiononin, gjithashtu, edhe për takimet me prokurorin.

1.4 E DREJTA PËR SHËRBBIM SHËNDETËSOR

E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë kushtetuese e cila duhet t'i garantohet çdo individ. Organet kompetente duhet të marrin të gjitha masat për ofrimin e këtij shërbimi, si një ndër detyrimet pozitive të shtetit ndaj shtetasve të vet, veçanërisht ndaj atyre që ndodhen nën trajtimin dhe përgjegjësinë e institucioneve shtetërore.

Sipas Manualit të Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore, pika 7 parashikohet se: *“Para sistemimit/akomodimit në dhomat e sigurisë, një punonjës policie i nivelit të parë drejtues i shërbimeve të rendit, ...dhe mjeku, kryejnë intervistimin, verifikimin dhe këqyrjen e jashtme të arrestuarit/ndaluarit nëse ka shenja të ushtrimit të dhunës, keqtrajtimit, sëmundje të ndryshme që kanë nevojë për ndihmë mjekësore apo ankesa të tjera të kësaj natyre. Detyrimisht në këtë moment sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 12 orë pas ndalimit/arrestimit kryhet kontrolli/vizita mjekësore nga mjeku apo ndihmës mjeku i drejtorisë/komisariatit të policisë. Në rast se personi refuzon, duhet të dokumentohet. Në rastet e të miturve, ky kontroll/ vizitë kryhet me pëlqimin e prindërve apo të kujdestarit të të miturit.*

Nga monitorimi rezultoi se, duke qenë se shërbimi shëndetësor ofrohej nga mjeku ose ndihmës mjeku i Drejtorisë Vendore të Policisë, shumë

prej komisariateve të varësisë, rezultonin të pa mbuluara me shërbim shëndetësor, sepse ky personel nuk i përgjigjej dot të gjitha nevojave për shërbim shëndetësor në të gjitha strukturat e vartësisë. Kjo bëhej më e evidente, sidomos në rastet kur komisarariatet ishin tepër të distancuara nga selia e Drejtorive Vendore të Policisë së Shtetit. Në disa raste si, në Komisariatin e Krujës, kur paraqitej e nevojshme, thirrej dhe vinte mjeku i spitalit të qytetit për të ofruar shërbimin shëndetësor. Në Komisariatin e Burrelit, për raste të ngutshme, shërbimi shëndetësor ofrohej nga mjekja e institucionit të IEVP Burrel dhe kur paraqitej e nevojshme personat dërgoheshin në Spitalin Rajonal të Burrelit, pasi kishin një dhomë të posaçme për të ofruar shërbimin shëndetësor personave që mbaheshin në Komisariatin e Burrelit. Po ashtu, për raste urgjente, u konstatua se ekzistonte një bashkëpunim i mirë ndërmjet komisariateve policore me spitalet përkatëse.

KShH, dëshiron të theksojë të nevojshme plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucioneve policore, sikurse në Komisariatin e Korçës ku mjeku ishte larguar. Funksionet të tilla janë tepër të nevojshme për institucionin prandaj duhet të plotësohen, sa më parë dhe gjithmonë konform kërkesave ligjore që kërkon detyra. Nga monitorimi në Komisariatin e Kukësit rezultoi se organika dhe nevojat ishin për një mjek, por ishte punësuar një infermier.

KShH, sugjeroi të merren më shumë masat e nevojshme, nga ana e strukturave përkatëse, për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore në ambientet e policisë. Nga monitorimet ka rezultuar se ky aspekt lë për të dëshiruar. Mjaft e rëndësishme është edhe furnizimi me medikamentet e nevojshme për t’iu përgjigjur nevojave për shërbim shëndetësor ndaj personave që trajtohen në komisarariatet e Drejtoritë të Policisë së Shtetit. Gjatë monitorimit në Komisariatin e Gjirokastrës rezultoi se kishte mungesë të theksuar të furnizimit me medikamente si dhe aksesore të tjerë shëndetësor, të cilat duhet të ndodheshin në kutinë së ndihmës së shpejtë mjekësore.

1.5 KONSTATIME TË TJERA

Standardet ligjore të të drejtave të personave të ndaluar arrestuar, në ambientet policore, parashikojnë se atyre duhet t’u mundësohet **ajrim**, jo më pak se 2 orë në ditë³⁵. Nga monitorimet ka rezultuar se, në mjaft raste, nuk ekziston infrastruktura e përshtatshëm për t’u realizuar kjo e drejtë.

35. Referuar “Manualit për Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”;

Në disa institucione policore ajrimi nuk realizohej kur kushtet atmosferike ishin të këqija sepse ambienti ishte i hapur dhe i papërshtatshëm. Është konstatuar respektim i kësaj të drejte vetëm në Komisariatin Nr. 1 Tiranë dhe në Komisariatin e Burrelit.

Sa i takon shërbimit të furnizimit me **ushqim**³⁶, një zgjidhje e mirë ishte përdorimi i shërbimit katering, ofruar nga kompanitë përkatëse, tri herë në ditë. Gjithsesi, u konstatua një rast ku ushqimi gatuhej në IEVP, si në rastin e Komisaritit të Kukësit, pasi ndodhej në të njëjtin ambient me IEVP Kukës dhe gatuhej në të njëjtën kuzhinë, pavarësisht se policia kishte kuzhinier të tijin në organikë. Përgjithësisht cilësia e ushqimit u vlerësua e mirë nga personat e ndaluar/arrestuar. Por, gjatë monitorimit në Komisariatin e Korçës u verifikua nga grupi i monitorimit vakti i drekës, i sjellë nga kompania përkatëse, i cili përbëhej nga një panine shumë e thjeshtë në asortimente (një panine e vogël me vezë të skuqur nuk mund të konsiderohet një vakt cilësor dhe me vlerat e duhura ushqimore), i cili rezultoi i pakonsumuar nga të ndaluarit. Pretendime për cilësi jo të mirë ushqimi u ngritën edhe në Komisariatin e Burrelit. Në standardet e KPT-së përcaktohet, shprehimisht se, një ushqim i plotë duhet të jetë diçka më shumë se një panine³⁷.

Sa i takon **raportit meshkuj dhe femra, në stafet e institucioneve të monitoruara, u vu** re një shtim i punonjësve femra me uniformë. Numri i punonjësve femra në institucion varionte nga 2 deri 30 punonjëse femra. Një praktikë e mirë, që vlen për t'u përmendur, është Komisarati i Beratit ku, së fundmi, janë punësuar 17 punonjëse femra. Në Komisariatin e Durrësit u referua se ka një shtim të punonjësve femra me rreth 50% të totalit.

Siç edhe përmendëm më sipër, një rëndësi e veçantë i është kushtuar personave të cilët vuajnë nga **çrregullime të shëndetit mendor**. Nga monitorimet ka rezultuar se në komisarate nuk rezultoi të kishte mjete të kufizimit fizik për personat që kanë çrregullime mendore dhe janë në momente axhitimi, si dhe as ambiente të përshtatura për trajtimin e tyre. Po ashtu, nuk ka procedura të shkruara që normojnë trajtim të diferencuar të këtij grupi në nevojë të shoqërisë sonë.

36. Idem, 1/1.16 parashikon se: "I arrestuari/ndaluari ka të drejtë të trajtohet me ushqim tre vakte në ditë sipas normave për këtë qëllim."

37. Pika 42/3 Fq. 7 <http://www.cpt.coe.int/en/documents/eng-standards.pdf>

I. SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET E POLICISË

Në vijim të gjetjeve të prezantuara më sipër, KShH dëshiron të japë disa sugjerime për përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave të njeriut, të personave që mbahen në këto ambiente.

1. Sugjerojmë të merren masa për përmirësimin e kushteve infrastrukturore, veçanërisht të dhomave të sigurisë dhe dhomave të shoqërimit. Kushtet infrastrukturore të konstatuar në disa komisariate përbëjnë bazë për trajtim çnjerëzor dhe degradues të personave që janë sistemuar në to.
2. Duhet të shihet mundësia e furnizimit me mjetet e nevojshme të higjienës, të tilla si, detergjent të ndryshëm, klor, sapun, shtupë për larjen e dyshemeve, etj.. Duhet marrë më tepër masa sigurie për parandalimin e infeksioneve dhe sëmundjeve të ndryshme që transmetohen midis personave.
3. Nga gjetjet e konstatuara përgjatë veprimtarisë monitoruese të kryer nga ekspertët e KShH-së është konstatuar fenomeni i mosndëshkimit për personat fajtorë që shkaktojnë shkelje ligjore dhe cënojnë të drejtat e shtetasve. Sugjerohet që autoritetet policore të analizojnë çdo shkelje në këtë drejtim dhe të vlerësojnë çdo rast me përgjegjësi dhe përgjegjshmëri, në mënyrë që shkeljet administrative dhe ligjore të punonjësve të policisë së shtetit, të gjejnë trajtimin e duhur nga organet ligj-zbatuese.
4. KShH sugjeron që, nën shembullin e Komisarariatit të Durrësit, të vendoseshin pajisje audio-video në ambientet e marrjes në pyetje të personave që trajton policia, në të gjitha institucionet policore. Kjo do të shmangte rastet e keqtrajtimit të mundshme gjatë këtij procesi.
5. Për t'u garantuar të drejtën për marrjen e shërbimit shëndetësor personave, që trajtohen nga policia, të merren masa që të plotësojnë nevojat për burime njerëzore, financiare, medikamente dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e këtij shërbimi.
6. KShH sugjeron gjithashtu të gjendet zgjidhje efektive për garantimin e të drejtës për të pasur shërbim psikologjik efektiv, sidomos në rastet e trajtimit të të miturive, që trajtohen në ambientet policore. Të ndërpritet, menjëherë, praktikat e shkrirjes së pozicionit të juristit me atë të psikologut , sepse janë dy profesione të ndryshme që kërkojnë arsimim specifik.

7. Gjithashtu, sugjerohet të rritet ndërgjegjësimi i punonjësve të policisë për t'u komunikuar, qartë e saktë, të drejtat shtetasve, që në momentin e parë të privimit të lirisë, si dhe arsyet e shoqërimit/ ndalimit/arrestimit. Po ashtu, të zbatohet praktika që personat e ndaluar/arrestuar të pajisen me një kopje të deklaratës së të drejtave gjatë qëndrimit të tyre në ambiente policore.
8. Të gjithë komisariatet dhe stacionet policore duhet të kenë një regjistër të posaçëm të kërkesë-ankesave. Duhet të ketë një ndërgjegjësim më të lartë të punonjësve për shënimin e çdo kërkesë apo ankese në regjistra të posaçëm, si dhe për trajtimin e drejtë dhe me paanësi të tyre.
9. Duhet të merren masa nga organet kompetente shtetërore për të shmangur vonesat në transferimin e personave të dënuar në mungesë, si dhe personave për të cilët është dhënë masa e sigurimit personal "Arrest me burg" për në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
10. Trajnimi bazë dhe vazhdues i punonjësve të policisë së shtetit, sidomos me objekt respektimin e të drejtave të shtetasve që vijnë në kontakt me këto organe, duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, serioz dhe në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të tyre. KShH sugjeron që punonjësit e policisë të niveleve të ndryshme drejtimi, nëpër të gjithë vendin, të angazhohen periodikisht në aktivitetet që rrisin kapacitetet e tyre profesionale.

KREU 2. SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE (BURGJE)

2. GJETJE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Pas misionëve të monitorimit të realizuara në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, KShH ka konkluduar në disa gjetje të cilat po i paraqesim të ndara, sipas tematikave, si më poshtë.

2.1 MBIPOPULLIMI

Mbipopullimi³⁸ është një ndër çështjet që i është kushtuar më shumë vëmendje gjatë misionëve të monitorimit në burgjeve. Në sistemin e burgjeve ndodhen aktualisht 6282 persona³⁹, ndërkohë që kapaciteti është 5484 persona, pra janë 798 persona, rreth 14.5% mbi kapacitet.

Vlen të përmendet se në IP Sarandë, që ka një kapacitet prej rreth 31 personash, në momentin e monitorimit tonë gjetëm të sistemuar 61 persona; në IEVP Zahari Krujë, më kapacitet 180 persona, gjetëm të sistemuar 244; në IEVP Lezhë, me kapacitet rreth 667 persona, gjetëm 836 të burgosur, etj...Mbipopullimi në burgje, përveç problematikave të tjera, shkakton dhe rritjen e kostove financiare për buxhetin e shtetit. Prej të dhënave të publikuara nga DPB rezulton se kostoja, për mbulimin e nevojave për një të burgosur në ditë shkon në 12.3 euro dhe 14.63 euro

38. Mbipopullimi rezulton i konstatuar si problem i madh edhe në Dokumentin Analitik "Informacioni i detajuar sipas sektorëve të sistemit të drejtësisë", Fq.87;

39. Faqa zyrtare e DPB, të dhëna për muajn Janar 2016, Këto shifra kanë rezultuar pas aplikimit të Ligjit "Për amnistinë" ku u liruan 968 të dënuar, <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=580>

dita për një të paraburgosur, ndërkohë që për personat e sëmurë kjo shifër rritet edhe më shumë duke shkuar në 46 euro dita.

Nga analizimi i situatës rezulton se disa nga shkaqet që kanë shkaktuar mbipopullim në burgje janë: 1. Ashpërsimi i politikave penale për disa vepra penale, të cilat më parë nuk dënoheshin me burg; 2. Fushata nxitëse e drejtuesve të qeverisë për aplikimin e dënimeve me burgim për disa kategori veprash penale. 3. Zbatimi në masë të ulët i dënimeve alternative nga gjykatat; 4. Dhënia në masë e masës së sigurimit personal “Arrest me burg”; 5. Mbajtja padrejtësisht e personave më masë mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shttrim i përkohshëm” në institucionet e burgimit etj...

Në Nenin 47 të Kodit Penal parashikohet se: *“....Në caktimin e dënimit ndaj personit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*. Neni 230 i K. Procedurës Penale parashikon se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit”*.

Ndërkohë legjislacioni ynë parashikon disa dënime alternative të tilla si: Neni 58 i Kodit Penal “Gjysmë liria, Neni 59/a “Qëndrimi në shtëpi”, etj.⁴⁰ Nga të dhënat e Shërbimit të Provës rezulton se gjatë muajt Shtator (raporti i fundit i publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni) rezulton se më shpesh gjykatat kanë aplikuar Nenin 59 të Kodit Penal, që lidhet me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burg dhe vënien në provë të të dënuarit dhe Nenin 63 të Kodit Penal, që lidhet me punën për interes publik. Ndërkohë, që prej fillimit të funksionimit të Shërbimit të Provës dhe deri në fund të vitit 2014, është dhënë vetëm një dënim me gjysmë lirie dhe 237 dënime “Qëndrim në shtëpi”.

Nga monitorimet tona na ka rezultuar se, si shkak i mbipopullimit, por dhe i keqadministritimit të burgjeve, ka ndodhur që në të njëjtën dhomë janë vendosur të dënuar me burgim të përjetshëm me të dënuar me masë të ulët, deri në pesë vjet burg. Këta të fundit, sipas akteve normative, duhej të sistemoheshin në burgje të sigurisë së ulët. Ky rast është evidentuar në IEVP Peqin⁴¹. Gjithashtu janë konstatuar raste kur qëndronin në të njëjtën

40. Referuar të dhënave të Shërbimit të Provës nga Raporti Shtator 2015, për periudhën 01.09.2015 – 30.09.2015 janë dhënë 343 dënime alternative. Deri më datë 30.09.2015 rezulton se në total janë në mbikqyrje 8779 të dënuar. http://www.sherbimiproves.gov.al/images/pdf/Raport_Shtator_2015.pdf

Për vitin 2014 janë dhënë 4003 dënime alternative; <http://www.sherbimiproves.gov.al/index.php/al/aktiviteti-yne/te-dhena-statistikore>

41. Ditën e monitorimit u referua se nga 620 që është kapaciteti i institucionit ndodheshin 780 të dënuar;

dhomë të paraburgosur dhe të dënuar me vendim të formës së prerë⁴².

Hapja e institucioneve të reja të Fierit dhe të Beratit ndikoi disi në **uljen e mbipopullimit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015**. Po ashtu rihapja për funksionim e IP “Jordan Misja” Tiranë ndikoi në uljen e tij. Gjithashtu hyrja në fuqi e ligjit për amnistinë, të miratuar në Janar të 2016, i dha mundësinë rreth 968⁴³ të dënuarve të lënë këto institucione. Megjithatë, fenomeni i recidivizmit, që rezulton i përhapur në vendin tonë bën, që një pjesë e të dënuarve që përfitojnë nga amnistia, kthehen përsëri në burg, pasi kryejnë vepra të tjera penale. Kjo tregon se dhe puna edukuese dhe rehabilituese, që zhvillohet në burgje, nuk ka efektivitet të lartë.

KShH, vlerëson masat e marra nga institucionet shtetërore për uljen e mbipopullimit në burgje, por vlerëson se ndaj këtij fenomeni duhen gjetur zgjidhje më efikente dhe të merren masa, afatmesme dhe afatgjata, për evitimin e problematikës, sepse mbipopullimi në burgje, përveç të tjerave krijon dhe rrethana, e të cilit mund të shkaktojë trajtim çnjerëzor e degradues për të burgosurit.

2.2 KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Sipas Rregullores Evropiane të Burgjeve, *“Kushtet në burg, që çënojnë të drejtat e njeriut për të burgosurit, nuk mund të justifikohen nga mungesa e burimeve financiare e materiale të strukturave të shtetit”*.

Ligji Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikon se: *“Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, si dhe të plotësojnë kërkesat individuale të të paraburgosurve dhe të dënuarve”⁴⁴. Mjediset, në të cilat jetojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit, duhet të kenë hapësira të mjaftueshme, me ndriçim të nevojshëm natyror dhe artificial, për të bërë të mundur qëndrimin, punën dhe çlodhjen aktive, të ajrosura dhe të pajisura me shërbimet higjienike. Atje ku e kërkojnë kushtet klimaterike duhet të sigurohet edhe ngrohja e mjediseve....Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar sigurohet shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.”⁴⁵*

42. IEPV Lezhë;

43. Faqa zyrtare e DPB <http://www.dpbsh.gov.al/neweeb/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=571> ;

44 Neni 23;

45 Neni24;

Nga monitorimet ka rezultuar se disa nga institucionet e vëzhguara⁴⁶ ishin në kushte mjaft të mjerueshme dhe me godina të **amortizuara** (psh. IEVP Krujë dhe IVSHB). Në IP Kukës, dhomat e regjimit ndodheshin rreth 1.5m nën tokë, me mungesë ajrimi, ose ndriçimi të mjaftueshëm natyral. Në komunikimet zyrtare me DPB, është referuar se për përmirësimin e gjendjes së amortizuar të godinës së IVSHB-së, është bashkëpunuar me organizatën “Hope for Albania” dhe Shoqatën Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë. Është në proces zbatimi i projektit për rikonstruksionin e godinës së IVSHB, i cili do të konsistojë në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe përmirësimin e kapacitetit akomodues të këtij institucioni. Ndërkohë, janë marrë masa për riparimin e dusheve dhe tualeteve. Aktualisht, është realizuar izolimi i tarracës së institucionit. Është lënë detyrë furnizimi i menjëhershëm me batanije, çarçafë dyshek, etj, në magazinat e DPB.

Higjiena është një faktor tjetër i rëndësishëm, por që paraqet probleme në institucione. Nga monitorimet rezultoi se ka, në disa raste, ambiente të papastra. Kjo gjendje është konstatuar në dhomat e regjimit, dhomat e takimeve speciale, sallat e aktiviteteve, etj... Në drejtim të mungesës së higjienës ndër institucionet më problematike kanë rezultuar IEVP Lezhë, dhe IEVP Krujë ku u konstatua prania, në masë, e insekteve. Vihej re se, në përgjithësi, institucionet nuk furnizoheshin mjaftueshëm me detergjentët e nevojshëm për të burgosurit, që të mbanin higjienën personale dhe të ambienteve të përgjithshme. Problem ishte dhe mungesa e furnizimit 24 orë me ujë të rrjedhshëm në disa institucione.

Furnizimi me ujë paraqiti problem në disa raste. Kishte të dënuar që për shkak të mungesës së ujit të rrjedhshëm përdornin ujë të ambalazhuar, të tregut, për nevojat e tyre të ndryshme⁴⁷. Në këtë drejtim më problematike u paraqit situata në IVM Kavajë. Në këtë institucion përdorej uji i pusit, i cili kishte rezultuar me bakterin “Esheriakoli” dhe për pasojë nuk duhet të përdorej për konsum njerëzor, sepse përbënte burim për përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme. Në IEVP Korçë ishin të shumtë personat të cilët u ankuan për ujin e rrjedhshëm të rubinetit që vinte me ngjyrë dhe erë të keqe, duke u konsideruar i papërdorshëm për t’u pirë, nga ana e tyre.

46. Sipas Progres Raportit për Shqipërinë 10.11.2015, Fq.58 shprehet se: “Nevojiten më shumë përpjekje për të përmirësuar kushtet e burgjeve dhe për të adresuar mbipopullimin në burgje dhe paraburgime;

47. IP Kukës gjatë periudhës së verës ka patur mungesë furnizimi 24 orë me ujë dhe problem ishte lehtësuar pjesërisht me bot uji (makina). Në IP Elbasan të paraburgosurit e sektorit të kujdesit të veçantë u shprehën se laheshin me kovë dhe me shishe në tualetet e brendshme të dhomës për arsye të mungesës së furnizimit me ujë 24 orë;

Nga monitorimet ka rezultuar se në mjaft raste dhomat nuk i plotësojnë **standardet e hapësirës** për të burgosurit. Në dy dhoma, të IEVP Peqin e Lezhë, u konstatua se gjendeshin të sistemuar, përkatësisht 15 persona (IEVP Peqin), ku 3 prej tyre flinin, me dyshekë në dysheme dhe në institucionin e dytë 16 persona në një dhomë, ku 2 prej tyre flinin me dyshek në dysheme në një dhomë me sipërfaqe rreth 28m² KPT shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu , sipas standardit të KPT, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.⁴⁸ Ky standard shkelej në IP Sarandë, IEVP Krujë, IVSHB, IEVP Peqin, IEVP Lezhë etj... Në disa institucione është konstatuar se të **burgosurit flinin në dysheme** vetëm me një dyshek sfungjeri të hollë. Problem shqetësues janë dhe xhamat e thyer të dritareve, që u konstatuan në IEVP Krujë, IEVP Burrel, Lezhë dhe Korçë.

Edhe në lidhje me garantimin e ngrohjes konstatuam probleme, të cilat mbarten nga periudhat e mëparshme, veçanërisht në IEVP Lezhë dhe IVSHB. Prej mëse 2 vjetësh IVSHB nuk furnizohej me lëndë djegëse. Godina aktuale ka qënë pjesë e QSUT “Nënë Tereza” dhe vazhdojnë ta kenë të përbashkët rrjetin e furnizimit me ngrohje. Mirëpo, prej 2 vitesh, drejtuesit e institucioneve (QSUT dhe IVSHB), që kanë vartësi administrative dhe buxhete të veçanta, nuk kishte arritur dot një marrëveshje ndërmjet tyre për zgjidhjen e këtij problemi. Ky shqetësim i është adresuar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Problem me ngrohjen u konstatua në IEVP Lezhë, ku të burgosurit mbulonin dritaret e dhomave me batanije për t’u mbrojtur nga i ftohti.

Përgjithësisht, **dushet e tualetet** rezultuan në gjendje të mjerueshme. Në disa raste dushet nuk ishin fare funksional (si p.sh. në një sektorë në IP Durrës). Në disa institucione mungonin kokat e dusheve dhe tualetet ishin me dyer të thyera e të ndryshkura. Këto ambiente kishin mjaft lagështirë dhe shpesh ishin të papastra, duke përbërë rrezik për infeksione e sëmundje të tjera.

48. Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

Në IEVP Krujë, u konstatuan raste ku nuk mundësohej menjëherë **aksesi për në tualet** dhe për këtë arsye, nevojat personale kryheshin në një kovë, që mbahej në dhomë. Tualeti i dhomës së observimit në IVM Kavajë rezultoi i ndotur, për arsye se të mituri nuk kishin pranuar të kryenin pastrimin. Në tualetet e IEVP Lezhë pikonin ujërat e zeza nga kati i mësipërm, ndërsa tek dushet vetë të burgosurit kishin vendosur plastmasë, në pjesën e sipërme të tavanit, për t'u mbrojtur nga ujërat e zeza që pikonin nga banjat e një kati më sipër. Kushte të tilla janë të patolerueshme dhe krijojnë rrethana për trajtim çnjerëzor dhe degradues të të burgosurve.

Lidhur me **ushqimin**, KShH ka marrë vazhdimisht ankesa nga të burgosurit për cilësinë e tij. Një masë e madhe e të burgosurve nuk e konsumojnë ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinave të institucioneve, rezultuan në gjendje të mirë. Në mjaft raste, gjatë monitorimeve KShH ka qenë prezent gjatë shpërndarjes së vaktit të drekës dhe ka patur mundësi të verifikojë shumëllojshmërinë e ushqimit të ofruar. Si një shembull pozitiv mund të përmendim IVSHB, ku ushqimi ofrohej i paketuar dhe i sistemuar mirë gjatë shpërndarjes (në formën catering). Në këtë institucion ofrohej ushqim në racione për diabetikët, ose për personat me sëmundje të tjera, sipas rekomandimeve të mjekut. Pretendime për mungesën e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së ushqimit ka pasur në IEVP Tepelenë, IEVP Fier, Korçë, etj...⁴⁹. Nga regjistrat e verifikuar ka rezultuar se prej disa 4 muajsh, në IEVP Krujë, ofrohej e njëjta menu.

2.3 SIGURIA DHE TË NDJERIT TË SIGURT

Siguria dhe të ndjerit të sigurt në institucionet penitenciare janë elemente mjaft të rëndësishëm për mbarëvajtjen dhe mirë drejtimin e tyre. Drejtuesit e institucioneve duhet të marrin të gjitha masat për të parandaluar dhe administruar situatat që çenojnë sigurinë. Ligji⁴⁹ Nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" në Nenin 22 parashikon se: *"Policia e Burgjeve ka për mision ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të të paraburgosurve dhe të dënuarve në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut"*.

49. Psh. Në IEVP Burrel nga verifikimi i regjistrat të ushqimeve rezultonte pothuajse ushqim i njëjtë për çdo ditë, duke konstatuar pretendimet e disa prej të dënuarve të kontaktuar;

Një rast shqetësues, që KShH vlerësoi të sjellë në vëmendje, në këtë raport, lidhet me pretendimin e një të dënuari në IEVP Zahari Krujë, se ndaj tij është kryer abuzim seksual nga një tjetër i dënuar, që qëndron në të njëjtin institucion. Lidhur më këtë, i dënuari në fjalë i është drejtuar edhe organit të Prokurorisë. Pavarësisht hetimeve/veprimeve procedurale, që ndërmerr organi procedues për këtë rast, duhet theksuar se ky është një pretendim që duhet vlerësuar shumë seriozisht nga autoritetet e burgjeve dhe duhet të nxitë, të paktën, rritjen e vëmendjes ndaj fenomenit dhe marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe të ndjerit të sigurt në institucionet penitenciare.

Sa i takon tentativa për vetëvrasje, ato nuk kanë munguar, ka patur të tilla në IP Durrës, IEVP Krujë, IEVP Lezhë, IEVP Sarandë, IEVP Tepelenë, IEVP Vaqarr dhe IEVP Fier. Nga rastet e referuara, ka rezultuar se pjesa më e madhe e personave që kanë tentuar të vetëvriten vuajnë dhe kurohen për çrregullime të shëndetit mendor. Është konstatuar se këtyre rasteve nuk u është kushtuar vëmendje maksimale nga sektorët përkatës dhe se jo gjithmonë masat e marra kanë qenë të duhurat e në përputhje me protokollet në fuqi. Konkretisht në IEVP Tepelenë, nga një i burgosur u pretendua se, pasi kishte tentuar të vetëvritej, duke përdorur një brisk rroje ishte dërguar menjëherë në spitalin e Gjirokastrës për ndihmën e emergjencës e më pas u transferua në IVSHB Tiranë, ku kishte marrë ndihmën e nevojshme dhe se ishte mbajtur i lidhur me zinxhirë, për 7 ditë rresht, i shtrirë në shtrat. Aktualisht qëndronte në një dhomë me 8 persona, në kushte tepër të vështira jetese. Përveç ajrimit nuk merrte pjesë në asnjë aktivitet fizik. Ky është një fakt i rëndë, i cili bie ndesh me politikën, që po zbaton Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për këtë grup individësh në nevojë, politikë e veçantë për trajtimin e personave me çrregullime mendore.

Nga vrojtimi i regjistrit të masave disiplinore ka rezultuar se, pothuaj në çdo institucion të monitoruar, për shkak të fenomenit të futjes dhe përdorimit të sendeve të ndaluara nga të burgosurit, jepeshin masa disiplinore ndaj tyre. Kjo e dhënë është e lidhur ngushtësisht me sigurinë në këto institucione. Nga monitorimet ka rezultuar se sendet e ndaluara, shpesh, janë celularë, por në një rast është gjetur thikë, apo sende të tjera të mprehta dhe që mund të shkaktojnë dëmtim të shëndetit. Mungesa e aparateve të skanerit, në disa IEVP, në pikat e kontrollit të ushqimeve, të familjarëve, miqve që vijnë të takojnë të dënuarit, si dhe të punonjësve të institucioneve, mundëson kalimin e sendeve të ndaluara në këto institucione. Personat me liri të kufizuar kanë pretenduar se ky “shërbim” kryhet nga personeli i korruptuar, kundrejt pagesës. Një fakt i tillë, i ndodhur në IEVP Korçë, u bë publik nga mediat. Gjatë muajit dhjetor 2015, Kodi Penal i R.Sh ka pësuar një amendim, duke ashpërsuar

sanksionet, që lidhet me dënimin e personave që tentojnë të fusin apo përdorin sende të ndaluara në burgje.

2.4 TRAJTIMI I TË DËNUARVE, REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI, INDIVIDUALIZIMI I DËNIMIT, PROGRAMI DITOR

Një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror.⁵⁰

Në përgjithësi vihet re se, në shumicën e institucioneve të monitoruara, nuk zhvillohen **aktivitete të shumta rikrijuese apo sportive** (lojrat me top të tilla si futboll dhe basketboll). Por kishte dhe institucione të tilla si IEPV Durrës, IEPV Ali Demi, IVM Kavajë, ku rezultoi se këto aktivitete realizoheshin në vazhdimësi. Në disa institucione të tjera si, IVM Kavajë, IEPV Fushë Krujë dhe IEPV Lezhë, ofrohej si aktivitet fizik edhe palestra. Këto aktivitete organizoheshin në bazë të një grafiku mujor, të mirë përcaktuar, duke specifikuar se cilët persona do të merrnin pjesë. Më problematike në këtë drejtim u paraqit IEPV Sarandë, për shkak të mungesës së ambienteve dhe të mbipopullimit dhe IP Kukës ku, salla e aktivitetet ishte kthyer në dhomë për të burgosurit, gjithashtu, për shkak të mbipopullimit. Sa i takon veprimtarive rikrijuese, u vërejt se në institucionet e burgimit dhe paraburgimit ato që zhvilloheshin më së shumti ishin lojërat e tavolinës, pasi personat mund të luajnë edhe në dhomën e tyre, ose edhe në ambientet e ajrimit (lojra me letra, domino dhe shah). Gjithashtu, për të burgosurit që i kërkonin ato, ofroheshin seanca këshilluese individuale.

Shembull i veçantë ishte ai i IVSHB, ku stafi punonjës social blinin gazeta dhe u jepnin për t'i lexuar personave që qëndronin në këtë institucion, artikujt që mendonin se ishin të përshtatshëm dhe ndihmues për trajtimin e gjithsecilit prej tyre. Në këtë institucion zhvillohej dhe terapi muzikore, si terapi plotësuese me personat e sëmurë mendorë, e cila mendohet se jep rezultate përmirësimi shëndetësor të pacientëve. Shembull i mirë për

50. Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

realizimin e aktiviteteve rikrijuese e profesionale u gjetën edhe IEVP Ali Demi dhe IVM Kavajë.

Individualizimi i vuajtjes së dënimit është një detyrim pune që buron nga ligji, ende i parealizuar me shumicën e të burgosurve, në thuajse të gjitha institucionet e monitoruara nga KSHH. Kjo më së shumti për shkak të mungesës së burimeve materiale të institucioneve, të hapësirave dhe mundësive konkrete mbështetëse që ofrojnë ato. Shumë prej punonjësve të ekipeve multidisiplinare, por sidomos ata të sektorëve socialë, hasin vështirësi për hartimin e një programi individual për të burgosurit, të zbatueshëm në institucion.

Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse, që vlen të përgëzohet, ka konsistuar në realizimin e aktiviteteve të ndryshme argëtuese si p.sh. aktivitete festive me këngë dhe vegla muzikore, si dhe në dhënien e ndihmave të tilla si veshje, libra etj. Institucionet rezultojnë se kanë bashkëpunuar me SHKBSH, Qendra MERIDIA, Kisha Katolike, Kisha Ortodokse, Komuniteti Mysliman, Dëshmitarët e Jehovait, Shoqata Motrat Nënë Tereza si dhe me institucionet shtetërore si Bashkia e Fierit.

2.5 E DREJTA E KËRKESËS DHE E ANKESËS

E drejta për kërkesë dhe ankesë merr një rëndësi thelbësore për personat e privuar nga liria. Kjo e drejtë është e garantuar në aktet më të larta ndërkombëtare. Ligji Nr. 8328, datë 16.04.1998 shprehet se: *“Të dënuarit dhe të paraburgosurit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe të rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale⁵¹.*

Nga monitorimet ka rezultuar se të dënuarit dhe të paraburgosurit e ushtrojnë të drejtën e tyre për të drejtuar kërkesë-ankesë dhe marrin dijeni lidhur me këtë në momentin e pranimit në institucion. Nga këqyrja e regjistrit përkatës, janë gjetur të regjistruara vetëm kërkesa. Regjistri ka si qëllim që të regjistrohen kërkesat, por edhe ankesat të çfarëdo lloji. Këto kërkesa rezultuan të mbajtura rregullisht nga personeli përkatës dhe nuk nënvlerësoheshin.

Në IVM Kavajë u vu re se ky regjistër nuk ishte i njëjti model me regjistrin standard dhe kishte vite që përdorej si i tillë. Në të mungonte një kolonë ku të shënohej mënyra e marrjes së kërkesës, apo ankesës, si dhe kolona ku të shënohet zgjidhja e tyre. Do të ishte mirë që të gjitha institucionet të kenë një regjistër të vetëm sipas modelit të përcaktuar nga DPB.

51. Neni 8 i Ligjit;

Kërkesat drejtoheshin në mënyrë verbale ose me shkrim dhe përgjithësisht i jepej zgjidhje brenda 2 ditëve. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin e: leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për telefonata shtesë, takim me avokatë, takim me psikologun, vizitë në spital, ndryshim dhome, takime speciale, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Megjithatë të dënuarit nuk hezitojnë të parashtrojnë ankesa përpara të gjitha subjekteve që monitorojnë këto institucione. Kjo sjellje e të burgosurve tregon se nuk ndihen të lirë të ankohen drejtpërsëdrejti në institucion, ose organet e prokurorisë.

2.6 KUJDESI SHËNDETËSOR

E drejta për shërbim shëndetësor është një e drejtë e rëndësishme e cila duhet t'i garantohet çdo individ me liri të kufizuar, pa përjashtime dhe pa diskriminim. Organet kompetente duhet të marrin të gjitha masat që ky shërbim të përmbushë standardet më të larta, e të jetë sa më eficient në funksion të shëndetit të personave që e përfitojnë atë. Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*⁵².

KShH vlerëson shqetësuese situatën në IVSHB, sepse ky institucion nuk kishte të garantuar, gjithmonë, për të marrë ofrimin e **shërbimit shëndetësor për të burgosurit e paraburgosurit**, lehtësisht nga QSUT “Nënë Tereza”, pranë të cilit është atashuar. Për këtë arsye ishte lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me nr. prot 4764, datë 27.06.2014 ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), e cila nuk zbatohej rregullisht, siç ishte marrë përsipër nga MSh, lidhur me ofrimin e ekzaminimeve dhe ndërhyrjeve kirurgjikale kur lind nevoja. Në institucionet e tjera penitenciare, në rrethe, rezultoi se reflektohej një bashkëpunim i mirë i tyre me spitalet rajonale, për të zgjidhur emergjencat shëndetësore, kur kërkohej një shërbim shëndetësor më i kualifikuar dhe i menjëhershëm.

Ka rezultuar, gjithashtu se, IEVP Tepelenë, Durrës etj... nuk ishte kryer pajisja me librezë shëndetësore e të burgosurve. Pretendohej se një grup,

52. Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

relativisht i lartë të burgosurish, nuk kishin kartë identiteti të depozituar në institucionin e vuajtjes së dënimit, nuk mund të pajiseshin me kartelë mjekësore dhe nuk mund të përfitojnë nga skema e rimbursueshme e medikamenteve. Ky është një pretendim i pavend sepse DPB, si pjesë e administratës së lartë shtetërore ka gjithë mundësitë që nëpërmjet sistemit elektronik të unifikuar shtetëror ta zgjidhë këtë problem.

Janë paraqitur mjaft ankesa lidhur me **shërbimin stomatologjik**. Kjo për arsye se në mjaft raste ofrohet qetësimi i dhimbjeve, por jo trajtimi stomatologjik i dhëmbëve të dëmtuar ose të sëmurë, duke e limituar ofrimin e shërbimit dentar vetëm në heqje dhëmbësh-dhëmballësh, apo mjekime për dhimbje me qetësimin e dhimbjes. Rast pozitiv përbënte institucioni i të miturve në Kavajë, ku shërbimi ishte i plotë (gjithsesi kujtojmë se uji i këtij institucioni ishte i infektuar me “Esheriakoli”). Sa i takon infrastrukturës mjekësore, rezultoi se kishte mjaft probleme në IEVP Lezhë, ku pajisjet ishin mjaft të amortizuara, në IP Elbasan, ku mungonte poltroni për të ofruar shërbimin, etj...

Nga monitorimet ka rezultuar se ka institucione që paraqiten me **vende vakante pune** të stafit të kujdesit shëndetësor (IEVP Krujë, IVSHB, etj). Mungesa të tilla kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marra masa të menjëhershme për plotësimin e stafit pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t’i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda. U konstatua angazhim serioz i institucioneve lokale dhe DPB për t’i zgjidhur sa më shpejt këto probleme. KShH, vlerëson pozitivisht masat e marra nga drejtuesit e IEVP Sarandë për punësimin e një mjeku me kohë të plotë pasi mjeku i mëparshëm punonte me kohë të pjesshme.

Në IEVP Krujë, mungesa e një mjeku psikiatër ishte zgjidhur në një mënyrë alternative duke e ofruar këtë shërbim nga 2 mjekë psikiatër nga IVSHB dhe IEVP Durrës, të cilët kryenin vizitat mjekësore 2 herë në muaj, të kombinuara me njeri-tjetrin. Në këtë institucion rezultoi se për shkak se një prej mjekëve ishte me KMACP, i cili punonte vetëm 6 orë në ditë, pjesa tjetër e stafit duhet të punonte orë shtesë për të mbuluar nevojat e punës. Shefja e Shëndetësisë kryente rreth 4-5 shërbime në muaj nga 24 orë për të cilat paguhej vetëm për orarin zyrtar dhe për orët e darkës për vështirësi pune. Pjesa tjetër e stafit mjekësor realizonte deri në 9-11 shërbime në muaj nga 24 orë. Në këtë institucion, në periudhën e monitorimit, mungonin 2 infermierë dhe një kujdestar. Mungesa e personelit të mjaftueshëm “kujdestar” çënon rëndë të drejtën për garantimin e shërbimit shëndetësor.

Lidhur me të drejtën për garantimin e shërbimit shëndetësor KShH, sjell në vëmendje një çështje gjyqësore të përfaqësuar prej organizatës sonë, lidhur me garantimin e shërbimit shëndetësor në burgje. Ankuesi, një i dënuar në IEVP Krujë, pretendonte se nuk i ishte garantuar shërbimi shëndetësor i duhur, duke i shkaktuar trajtimin çnjerëzor e degradues, sepse ky fakt kishte rënduar së tepërmi gjendjen e tij shëndetësore e fizike. Ankuesi, për shkak të plagës së marrë shoqëruar me thyerje kockës, në kofshën e majtë, e cila i ishte shkaktuar me armë zjarri, në momentet e ndalimit, iu nënshtrua një operacioni i cili nuk rezultoi i suksesshëm. Më pas, me kalimin e viteve, plaga u infektua. Për pasojë nga akti mjeko ligjor rezulton se këmba e dëmtuar i është shkurtuar me 15 cm, gjë që pengon të ecurin normal. Plaga i ka shkaktuar dhe dëmtime të tjera që lidhen me sistemin e enëve të qarkullimit të gjakut etj. Përfundimisht nga ekspertiza është përcaktuar se ai ka humbur aftësinë e gjymtyrës në masën 70%. Në institucion ankuesi trajtohej me medikamente, që vetëm i qetësonin përkohësisht dhimbjet. Ndodhur në këto kushte raporti mjeko ligjor ka konkluduar se, si rrjedhojë e këtij trajtimi mjekësor të marrë pranë IEVP Krujë, gjendja shëndetësore e të burgosurit ka ardhur duke u rënduar dhe se ankuesi ka të nevojshme ndërhyrjen kirurgjikale dhe garantimin e një shërbimi të përshtatshëm mjekësor, sa më të shpejtë, e për kontrolle të vazhdueshme e trajtim të specializuar. Në vendimin e saj **Gjykata është shprehur se ka qenë detyrë e organeve shtetërore të burgjeve të garantojnë që kërkuesi të vuajë dënimin në kushtet të cilat janë në pajtim me dinjitetin njerëzor, se mënyra apo metoda e ekzekutimit të këtyre masave të dënimit të mos e nënshtrojnë atë ndaj ankthit apo mundit të një intensiteti të tillë, që e kapërcen nivelin e pashmangshmërisë të vuajtjes e cila është prezent në burg. Në përfundim Gjykata ka konkluduar se gjendja shëndetësore e ankuesit ka ardhur duke u rënduar dhe duke u përkeqësuar, duke i shkaktuar vuajtje jo të pakta, çka konsiderohen si trajtim çnjerëzor e poshtërues, në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së dhe neneve 25 dhe 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

Në institucionet ku, për shkak të numrit të madh të personave të burgosur, nevoja për staf shëndetësor paraqitet e madhe, jo vetëm që nuk duhet të ketë pakësime të stafit, por duhet të shikohet mundësia e shtimit të tyre. Në IEVP Fushë Krujë rezultoi se sektori i shëndetësisë ishte pakësuar në numër, ndërkohë që nga kontakti i marr me stafin dhe kërkesat e të burgosurve do të ishte mirë të shtohej organika me mjekë.

Mungesë medikamentesh u vunë re në IEVP Durrës⁵³, IVM Kavajë,

53. Nëpërmjet korrespondencës zyrtare është marrë informacion se IEVP Durrës është furnizuar pas vizitës monitoruese me medikamente të urgjencës dhe material mjekësor.

IEVP Lezhë, IEPV Fier dhe IEPV Tepelenë. Në IEPV Sarandë, për shkak të mungesës së një farmacisti me licencë, të burgosurit nuk mund të përfitonin barna me rimbursim. Drejtuesi i institucionit referoi se ishte në tratativa për punësimin e një farmacisti të licencuar. Shpesh institucionet e monitoruara u gjetën në mungesë të shumëllojshmërisë së medikamenteve, si dhe të cilësinë së duhur të tyre, sidomos sa i takon medikamenteve për trajtimin së sëmundjeve mendore si, në IEPV Lezhë dhe IEPV Burrel. Shumica e të burgosurve pohuan se i merrnin medikamentet prej familjarëve të tyre.

Institucionet nuk pajiseshin me sasi të duhura të mjeteve të nevojshme për kryerjen e analizave mjekësore⁵⁴ si dhe të ofrimit të shërbimit shëndetësor⁵⁵. Kjo mungesë bënte të mundur që të mos zbatohet parashikimi ligjor se çdo i burgosur në momentin i pranimit i nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore.⁵⁶ Në një institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit⁵⁷. U vu re edhe se kishte mungesë të furnizimit me kartela mjekësore. Këto të fundit fotokopjoheshin nga stafi shëndetësor e shumëfishoheshin.

Infrastruktura mjekësore rezultoi me probleme. Dhomat e shërbimit ishin me hapësira jo të mjaftueshme, shtrati i vizitave mjekësore nuk ishte i cilësisë së duhur dhe në mjaft raste, u vu re amortizim i ambienteve dhe pajisjeve të tjera. Në IEPV Lezhë rezultoi se, përveç që dhoma e mjekut ishte me hapësirë jo të mjaftueshme, mungonte dhe higjiena e duhur.

2.7 POLITIKA DISIPLINORE NË INSTITUCIONET VENDORE PENITENCIARE

Personat të cilët qëndrojnë në institucionet e privimit të lirisë kanë jo vetëm të drejta por edhe detyrime. Në rast të shkeljes së këtyre detyrimeve, të cilat parashikohen nga legjislacioni në fuqi, që rregullon këtë fushë, detyrimisht ata ju nënshtrohen sanksioneve respektive. Për shkeljet disiplinore zbatohen masat si: 1. Këshillim individual; 2. Vërejtje në prani të të dënuarve dhe të paraburgosurit; 3. Përfjashtim nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 10 ditë; 4. Përfjashtim nga ajrosja në grup por jo më shumë se 20 ditë; 5. Përfjashtim nga të gjitha

54. Mungoni epruveta, tuba kampionesh, etj..

55. IEPV Ali Demi mungonte sterilizator (një aerosteril jashtë funksionit përdorej si mbajtës lulesh në ambientet e institucionit), fisha për glukometrin, llampë diagnostifikim, etj;

56. Psh në IEPV Durrës, IEPV Krujë, IVM Kavajë;

57. Psh. IEPV Burrel;

veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë; 6. Mosdhënia e lejes⁵⁸.

Nga monitorimet ka rezultuar se masat disiplinore të aplikuara variojnë. **Masa që është dhënë më shpesh, në institucionet e monitoruara, ka rezultuar “përjashtimi nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë”.** Kjo masë më pas ndiqet nga masa disiplinore përjashtimi nga ajrosja në grup. Nga ana tjetër, masa e aplikuar më pak rezulton **“vërejtja në prani të dënuarve dhe të paraburgosurve”.** KShH sugjeron që masa “vërejtje në prani të burgosurve” dhe “këshillimi individual” të aplikohen më shumë, kur e lejojnë rrethanat e çështjes.

Lidhur me arsyet e aplikimit të masës disiplinore nga monitorimi i dokumentacionit përkatës rezultuan si: **grindje ndërmjet të burgosurve, goditje ndaj punonjësve me uniformë, gjetje të sendeve të ndaluara, përdorimi i fjalëve fyese, dëmtim i pasurisë së institucionit, kundërshtim i urdhrave të dhënë, etj.**

Përgjithësisht, procedura lidhur me komunikimin e masës disiplinore zbatohej, duke i dhënë të burgosurit, që kishte kryer shkeljen edhe një kopje të vendimit të autoritetit përkatës. Por, ka patur edhe raste kur kjo procedurë nuk është realizuar. Në IEVP Korçë, nga kontakti i marrë me një të burgosur në dhomën e veçimit, ky i fundit referoi se nuk i është dhënë kopje e vendimit dhe nuk i është komunikuar e drejta për të bërë ankim pranë Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Në IEVP Lezhë u konstatua një rast ku Urdhri i Drejtorit për dhënien e masës disiplinore nuk përmbante shprehimisht të drejtën e ankimit të masës në Komisionin e Apelimit të Masave Disiplinore. U vu re se tek një pjesë e stafëve ekzistonte një koncept i gabuar, ata shpreheshin se kopja e vendimit duhej dhënë vetëm nëse e kërkonte personi i ndëshkuar.

2.8 LEJET SHPËRBLYESE DHE ATO TË VEÇANTA

Bazuar në Ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998 rezulton se *lejet shpërblyese jepen kur paraqitet një përmirësim në ecurinë e të burgosurit sa i takon sjelljes së tij dhe pjesëmarrjes në aktivitetet gjatë kohës së qëndrimit në institucion*⁵⁹. Ndërsa lejet e veçanta jepen për arsye të tilla si: *sëmundje të rënda, ngjarje të rëndësishme familjare, vdekje, lindje, martesë si dhe dhënia e provimeve të personave të burgosur*⁶⁰. Kuptohet, se që i burgosuri të përfitojë leje shpërblyese ose të veçantë

58. Neni 53;

59. Neni 59;

60. Neni 60;

duket të përmbush parashikimet ligjore të renditura në ligj.

Nga monitorimet rezultoi se, në përgjithësi, standardet në këtë drejtim respektoheshin, megjithatë, në një rast në IEVP Ali Demi u konstatua shkelje e kësaj të drejte. E dënuara kishte aplikuar për leje shpërblyese dhe kishte marrë miratimin përkatës si nga institucioni ashtu edhe nga komisarati. Nga kontakti i marrë me sektorin e shëndetësisë rezultoi se e dënuara vuante nga çrregullime të shëndetit mendor, por sipas mjekes kishte përmirësime megjithëse sëmundja mbetej aktuale. Këto fakte rezultuan të provuara nga këqyrja e dokumenteve që dispononte institucioni. Pasi rezultoi se i gjithë dokumentacioni ligjor ishte plotësuar sipas kërkesave ligjore, doli më pas se pasi kërkesa i është dërguar DPB-së, përgjigja për refuzimin e kërkesës ishte komunikuar **nëpërmjet telefonit**.

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr.103, datë 14.02.2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçantë të personave të dënuar me burgim” *rezulton se drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e lejeve shpërblyese në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe të ulët⁶¹. Pasi përfundon procedura ligjore lidhur me shqyrtimin e kërkesës, drejtori i IEVP-së **me shkresë të veçantë** njofton drejtorin e përgjithshëm, i cili vendos për planifikimin e lejes⁶². Sa më sipër rezulton se është drejtuesi i institucionit autoriteti kompetent për dhënien e lejes dhe DPB vendos lidhur me planifikimin e lejes.*

Duhet kuptuar se kur plotësohen kushtet e paracaktuara dhënia e lejeve shpërblyese ka një impakt mjaft pozitiv dhe motivues tek personi. Në rast se pretendohet nga autoritetet përkatëse se mund të ketë një shkelje ligjore ose se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në ligj, etj, gjithmonë duke patur parasysh kompetencat e dhëna nga ligji, përgjigja duhet të jetë e argumentuar dhe **në mënyrë shkresore**.

Një fakt tjetër i evidentuar nga KShH lidhet me mosdhëniet e lejeve ndaj personave që nuk gëzojnë shtetësi shqiptare dhe një rast i tillë u konstatua në IEVP Lezhë. Nga kontakti i marrë me autoritetet e institucionit u referua se personat që janë shtetas të huaj nuk kanë të drejtë të përfitojnë leje shpërblyese ose të veçantë. Referuar *Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me Vendimin Nr. 437, datë 20.05.2015, nuk rezulton një ndalim i tillë ligjor. Kuptohet që për personat e huaj që janë rezident në vendin tonë gëzojnë të njëjtat*

61. Pika 1;

62. Pika 4;

të drejta si shtetasit shqiptar. Nuk rezultojnë akte nënligjore të tjera që të rregullojnë këtë situatë. KShH, sugjeron që ky problem të jetë në vëmendjen e strukturave kompetente me qëllim garantimin e të drejtave për çdokënd që i gëzon ato.

2.9 PUNËSIMI

Ligji Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” në Nenin 34 parashikohet se: *“Të gjithë të paraburgosurve dhe të dënuarve u njihet e drejta për të punuar. Puna organizohet nga drejtoria e institucionit, brenda dhe jashtë tij, duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera. Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave”*. Aktualisht rezulton se ende nuk është rregulluar specifikisht kjo e drejtë me anë të një VKM-je. Të dënuarit që punojnë vijnë të shpërblehen 3.9 ditë në muaj, me 90 lekë të reja shpërblim, të cilat derdhen në llogarinë e tyre bankare. Progres Raportit për Shqipërinë për vitin 2015⁶³ shprehet se: *“Ata pak të burgosur që punojnë marrin ulje të dënimit dhe jo kompensim”*. Aktet nënligjore lidhur me pagesat e punës së kryer nga të burgosurit duhet të përmirësohet. Ligji parashikon se puna shpërblehet dhe pagesa jepet si shpërblim në proporcion me punën e kryer, konform rregullave që do të përcaktohen me VKM. Faktikisht zbatohet një VKM shumë e vjetër që nuk pasqyron standardet aktuale ligjore.

2.10 TRAJTIMI I GRUPEVE NË POZITA TË DOBËTA: TË MITURIT, GRATË, TË SËMURËT MENDORË ETJ.

Gjatë punës së tij KShH, i ka kushtuar vëmendje të veçantë grupeve në pozita të dobëta të tillë si: të miturit, gratë dhe personat me çrregullime të shëndetit mendor, ose aftësi të tjera të kufizuara etj. Në vijim, do të paraqesim se cila ka qenë qasja e institucioneve të monitoruara lidhur me trajtimin e tyre, veçanërisht, për sa i takon përfshirjes në aktivitetet sociale dhe planeve riintegruese. Fokusi ynë i veçantë ka qenë garantimi i shërbimit shëndetësor personave me çrregullime të shëndetit mendor.

63. Fq.58 paragrafi 5;

a. Trajtimi i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor

Për personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucioneve penitenciare. Për këtë qëllim janë krijuar **sektorët e kujdesit të veçantë** në burgje. KShH ka qenë një nga promotorët e garantimit të këtij shërbimi ndaj këtij grupi individësh në burgje. Për këtë, i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë, gjatë monitorimeve, punës së kryer në këtë drejtim. Me keqardhje ekspertët e KSHH-së kanë konstatuar se kushtet infrastrukturore të mjediseve, ku janë vendosur kjo kategori personash, nuk kanë ndryshime nga dhomat ku vendosen zakonisht të dënuarit dhe të paraburgosurit e tjerë. Nuk kishte programe të plota trajtimi për këtë kategori të burgosurish dhe pjesën më të madhe të kohës ata e kalonin në dhomë. Gjithashtu, nuk u vërejt asnjë element i trajtimit të veçantë për qëllime terapeutike, duke rrezikuar që këta sektorë të përceptohen me elemente stigmatizues. Në komunikimet zyrtare me DPB, KShH ka theksuar rëndësinë e ofrimit të trajtimit të specializuar të kësaj kategorie të burgosurish dhe i ka ofruar atij institucioni materiale me eksperiencë bashkëkohore, që mund të përdoren për trajtimin e duhur të personave me çrregullime mendore në këto institucione.

Nga monitorimet rezultoi se mjaft shqetësuese u paraqit situata në IEVP Krujë. Nga intervistat me të burgosurit dhe nga këqyrja e dokumentacionit rezultoi se në këtë institucion pothuajse nuk ofroheshin aktivitete sportive për këtë grup individësh. Nga kontakti i marrë me stafin, fillimisht u pohua se të dënuarit nuk merrnin pjesë në aktivitete sportive me top, sepse përbënte “cënim të sigurisë së brendshme të institucionit”. Shumica e të burgosurve shpenzonin kohën e ndenjes jashtë dhomave vetëm me ajrim. Në rregulloren e institucionit, në Nenin 11/2 parashikohet se: *“Aktivitetet rehabilituese me të burgosurit ofrohet me një frekuencë 4 orë në ditë”*⁶⁴. Tjetër problematikë ishte se 90% e personave nuk vizitoheshin nga familjarët e tyre dhe institucioni nuk bënte asnjë përpjekje për të ndërmjetësuar në këtë drejtim.

Shqetësuese paraqitet akomodimi i personave që vuajnë nga çrregullime mendore të cilët vendosen në të njëjtat dhoma me personat të cilët gëzojnë shëndet të plotë. Në mjaft raste kjo kategori nuk mirëpritet dhe përbuzet nga pjesa tjetër e bashkëvuajtësve, sepse bezdisen prej tyre dhe shprehen se duhet të kujdesen për ta. Një problem i tillë u evidentua në IEVP Lezhë. Është detyrim ligjor përkushtimi i vëmendjes së veçantë për akomodim në dhomat e qëndrimit sipas tërë kritereve të përcaktuara

64. Rregullorja e Brendshme e IEVP Krujë, Miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.5324, datë 07.06.2010;

në legjislacionin në fuqi për këtë kategori personash, në mënyrë që të shmangen pasoja të rënda.

Vijon të mbetet problematike vendosja në burg e personave ndaj të cilëve është dhënë masë mjekësore **“Mjekim i detyruar në një spital psikiatrik”**. Numri i tyre ka arritur rreth 164 persona. Pjesa më e madhe e tyre qëndron në IEVP Krujë dhe në IVSHB Tiranë. KShH i është drejtuar me shkresa zyrtare institucioneve më kryesore të vendit si: Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë dhe disa komisioneve të tij, Kryeministrit, Prokurorit të Përgjithshëm, ministrive relevante etj. Pati reagime nga pjesa më e madhe e institucioneve të cilat morën dijeni, por interes të veçantë shfaqti Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut në Kuvend. Të nxitur nga problematika e prezantuar nga KShH, u realizua një monitorim i përbashkët, ku morën pjesë përfaqësues të KShH dhe disa deputetë të këtij nënkomisioni, për të parë nga afër situatën aktuale në burgun e Krujës, me qëllim bashkëpunimin për përmirësimin e situatës dhe marrjen e masave urgjente.

KShH, vazhdimisht ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me nevojën urgjente për ndërtimin e institucionit të veçantë për këtë kategori personash me masë mjekësore, të cilët në mënyrë kategorike nuk duhen sistemuar në burgje, sepse ndaj tyre nuk ekziston asnjë masë dënimi penal me burgim. Organizata jonë vazhdimisht ka qenë aktive për të nxitur veprimet konkrete të institucioneve shtetërore për zgjidhjen e kësaj situate. KShH ka marrë dijeni se Ministrisë së Drejtësisë (Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve) dhe Ministrisë së Shëndetësisë ju janë vënë në dispozicion nga qeveria dy troje për ndërtimin e dy institucione, që do t’u shërbejnë personave me probleme të shëndetit mendor, përkatësisht personave me masë mjekësore dhe personave të dënuar që gjatë vuajtjes së dënimit janë sëmurur nga sëmundje mendore. KShH nxit strukturat shtetërore përgjegjëse për të përshpejtuar procedurat për ndërtimin e këtyre institucioneve, me qëllim që trajtimi i këtyre grupeve individësh të plotësojë standardet minimale të trajtimit në mënyrë njerëzore.

b. Trajtimi i të Miturve

Të miturit përbëjnë një grup specifik, i cili është konsideruar si grup prioritar i punës së DPB-ve këto vitet e fundit, por edhe i strukturave të tjera ligj-zbatuese. Aktualisht veprat penale, të kryera nga të miturit, gjykohen në seksionet e specializuara për të miturit, që janë krijuar në gjykata. Një ndër debatet e viteve të fundit lidhet me krijimin e gjykatave specifike për të miturit, ku të gjykohen veprat e kryera nga kjo kategori. Ky rekomandim është paraqitur edhe nga ekspertët e nivelit të lartë

lidhur me reformën në sistemin e drejtësisë⁶⁵. Vihet re se ka një rritje të numrit të të miturve në konflikt me ligjin vitet e fundit⁶⁶. Vijon të mbetet problematike mungesa e një institucioni për ekzekutimin e masave edukuese ndaj të miturve nën moshën e përgjegjësisë penale.

I vetmi institucion i specializuar për ekzekutimin e dënimeve penale, që jepen nga gjykata ndaj të miturve, është IVM Kavajë. Ndërkohë ka edhe sektorë paraburgimi për të miturit në institucione të tjera të tilla si IEVP Lezhë, IEVP Korçë dhe IEVP Vlorë. KSHH vlerëson rëndësinë e veçantë që i kushtohet trajtimit të kësaj kategorie të të dënuarve në institucionet penitenciare, sepse prej vitesh ka punuar për përmirësimin e respektimit të të drejtave të tyre në këto institucione. Në këtë kuadër, vlen të përmendet iniciativa e fundit, që KSHH po ndërmerr në kuadër të një projekti⁶⁷ që zbatohet nga Komiteti Holandez i Helsinkit, i mbështetur nga fondet e Ministrisë së Jashtme Holandeze, i cili ndër të tjera, synon rehabilitimin e plotë të të miturve në shoqëri, pas daljes nga institucionet penitenciare. Një nga shtyllat bazë të kësaj iniciative është qasja edukative që iu ofrohet të miturve në institucione penitenciare nga personeli i mirë trajnuar, në mënyrë që ata të ndryshojnë sjelljet të cilat i kanë sjellë në konflikt me ligjin.

Një nga institucionet ku zbatohet pjesërisht kjo qasje është edhe IVM Kavajë. Ofroheshin kurse profesionale për të miturit si: hidraulik, elektrik, punë me dru dhe saldator. Të miturit pjesëmarrës në këto kurse, ishin mjaft entuziastë për këtë mundësi dhe pasi përfundonin një prej kurseve, regjistroheshin edhe në kurset e tjera. Problematike paraqitet situata me furnizimin e lëndëve të para për realizimin e praktikës së punës në këto kurse, si p.sh. lënda drusore. Të miturit kishin krijuar punime të ndryshme me dru dhe kishin dëshirë të vijonin më tej, por përballeshin me mungesën e furnizimit me lëndë të parë drusore. Karriget dhe stolat e institucionit, në pjesën më të madhe, ishin realizuar nga të miturit që kishin ndjekur kursin përkatës. Organizoheshin edhe kurse pikturë, ku të miturit që shfaqnin interes ndihmoheshin nga një profesor i shkollës së artit në Kavajë. Të miturit luanin çdo ditë 2 orë futboll dhe dilnin në ajrim 3 orë në ditë, si dhe ju ofrohej të kryenin çdo ditë dush. Një pjesë e tyre ishin ndjekës të rregullt të fesë myslimane, duke shkuar çdo të premte në ambientet e improvizuara të xhamisë.

65. Numri më i lartë i të miturve të trajtuar është shënuar në vitin 2012 pra 232 të mitur, kundrejt 199 të miturve në vitin 2013 dhe 201 të miturve në vitin 2014. Vepra penale dominuese e kryer nga të miturit është vjedhje e ndjekur nga trafikim të lëndëve narkotike, Fq.74 http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI_2014_FINAL.pdf

66. Idem; Trendi i recidivistëve vjen në rritje, nga 28 recidivistëve në vitin 2012, në 35 për vitin 2013 duke arritur numrin më të lartë në tre vitet e fundit prej 59 për vitin 2014. Fq.75;

67. "Përmirësimi Kushteve për Riintegrimin e të miturve të burgosur në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë", Programi Matra CoPROL" financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme në Holandë";

Në IEVP Lezhë rezultoi se realizoheshin punime artistike të tilla si skulptura, shtëpi druri, etj.. Në këtë institucion pati pretendime nga disa të miturit se nuk ju mundësohej të merrnin pjesë në aktivitete sportive dhe se i vetmi aktivitet për ta ishte ajrimi.

Sa i takon marrëdhëniet me familjarët, institucionet tentonin të lehtësonin sa më shumë që të ishte e mundur këtë proces. Jo të gjithë të miturit kishin takime periodike me familjarët e tyre, ndonjëherë për shkak të largësisë gjeografike të familjeve të tyre, pamundësisë ekonomike apo edhe ftohjeve të marrëdhëniet midis tyre dhe të miturit të burgosur. Një përqindje e caktuar⁶⁸ e të miturve nuk kishin familjarë apo të afërm në Shqipëri.

Marrëdhëniet e të miturve me liri të kufizuar me personelin që punon me ta kanë rezultuar pozitive. Vihej re një frymë bashkëpunimi dhe komunikimi i hapur midis tyre. Në IVM Kavajë rezultoi se përveç rasteve kur e kërkonin të miturit, drejtuesi i institucionit kryente vizita periodike me ta, duke ju shkuar në dhomat e tyre. Ai kujdesej për të vlerësuar nga afër gjendjen e tyre.

Në IVM Kavajë zhvillohej programi mësimor në 4 klasa, dy i përkisnin ciklit të ulët dhe dy të tjerat ciklit të lartë. Shkolla funksiononte çdo ditë, nga ora 08:15 me 13:00 për ciklin e lartë dhe nga ora 08:15 me 11:45 për ciklin e ulët. Gjithashtu edhe në IEVP Korçë dhe IEVP Lezhë ofrohej arsimim ndaj të miturve që nuk kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm.

Nga monitroimi rezultoi se zbatoheshin masat edukative dhe masat disiplinore për të miturit. Nga dokumentet e këqyrrur rezultoi se zbatoheshin shpesh metoda TIME OUT, e cila i jep mundësi të miturit të reflektojnë për sjelljen jo të përshtatshme që ka kryer. Po ashtu, për shkelje të lehta disiplinore zbatoheshin udhëzuesi administrativ për të miturit.⁶⁹ Masat disiplinore tentoheshin të jepeshin rrallë, kur ishte e domosdoshme dhe në raste shkeljesh të rënda dhe nuk zgjasnin më shumë sesa pak ditë në veçim. Ato pasqyroheshin në regjistrin e masave disiplinore.

Shërbim shëndetësor rezultoi mjaft i mirë në IVM Kavajë. Çdo i mitur ishte i pajisur me kartelën e tij mjekësore dhe të plotësuar në mënyrë periodike në institucionet ku mbahet kjo kategori.

68. Personeli që punonte me të miturit nuk mbante statistika për këtë grup.

69. Referuar Udhëzuesit Administrativ në Sistemin e Burgjeve Shqiptare, Fq.6. Ky udhëzuesi administrative është rezultat i një iniciative të ndërmarrë disa vite më parë nga KSHH të mbështetur nga OSI Budapest, së bashku me një grup pune nga DPB dhe institucionet vendore penitenciare.

c. Trajnimi i grave të burgosura

Aktualisht, gratë të cilat janë të paraburgosura ose të dënuara qëndrojnë në IEVP Ali Demi. Në momentin e monitorimit u konstatuan 60 gra të paraburgosura dhe 48 të dënuara. Në rast se ka të mitura, të paraburgosura ose të dënuara, vendosen në dhoma të veçanta nga madhorët (u konstatuan 2 të mitura).

Infrastruktura luan një rol mjaft të rëndësishëm në rehabilitimin e personave të privuar nga liria. Pavarësisht, se në disa drejtime institucioni ka realizuar përparime, p.sh. për realizimin e programit të prindërimit në distancë duke krijuar kushtet e nevojshme për këtë qëllim, mendojmë se është urgjente nevoja për ndërtimin e një institucioni të ri për gratë. Godinat e këtij institucioni janë ndërtuar para shumë vitesh, janë në gjendje të amortizuar dhe të pozicionuara në mënyrë të papërshtatshme për zhvillimin e një jetese dhe veprimtarie riedukuese për komunitetin e grave me liri të kufizuar. Është i nevojshëm ndërtimi i një institucioni të ri për gratë duke respektuar standardet ligjore nga çdo pikëpamje.

Kushtet në dhomat e SKV rezultojnë të jenë relativisht të mira, të pastra, me piktura, 2 shtretër çdo dhomë, televizor, tavolinë, ndriçues. Tualeti i SKV ishte mjaft i papastër. Ambientet e ajrimit në SKV ishin mjaft të përshtatshme. Në të janë mbjellë disa pemë agrume. Megjithatë u konstatua se instalimet elektrike ishin të pa mbrojtura dhe telat e llambave ishin të varur.

Dhomat e veçimit nuk i plotësonin standardet ligjore sa i takon hapsirës. Rezultuan me sipërfaqe rreth 3 m² (1.50m gjerësi me 2 metra gjatësi) dhe nuk plotësonin standardet e duhura të ndriçimit natyral. U konstatua se këto ambiente ishin mjaft të pastra dhe nga stafi na u referua se përdorshin rrallë.

Sa i takon **shërbimit shëndetësor, na rezultoi se** gratë e paraburgosura, para së të pranoheshin në institucion, i nënshtrohen vizitës gjinekologjike dhe ECHO-s për të përcaktuar statusin e tyre riprodhues, krahas ekzaminimeve të tjera shëndetësore. Sipas mjekes së institucionit të sëmurat kronike monitorohen dhe mjekohen rregullisht nga personeli shëndetësor. Të sëmurat kronike janë monitoruar dhe mjekuar rregullisht nga personeli shëndetësor. Në institucion shërbimi shëndetësor mbulohet për 24 orë më infermier. Vizitat rutinë kryhen në infermieri të e paraburgimit dhe të burgimit nga mjekja e institucionit. Rastet, për të cilat kërkohen vizita të specializuara, ekzaminime laboratorike dhe radiologjike, referohen pranë mjekëve specialiste. Për urgjencat mjekësore ndihma e parë jepet në institucion, dërgimi për në qëndrën më të specializuar realizohet nga autoambulancat e IVSHB-së.

Marrëdhëniet me familjarët përgjithësisht paraqiteshin të mira, për pjesën më të madhe të grave të burgosurave, por ato shpesh ndërvaren nga lloji i veprës penale për të cilat akuzohen gratë. Stigma dhe paragjykimet e shoqërisë, të cilat reflektohen edhe në marrëdhëniet familjare të grave të paraburgosura, ose të burgosura, ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e këtyre marrëdhënieve.

Institucioni zbatonte program të prindërimit në distancë, për realizimin e të cilit, ishin marrë masa për krijimin e kushteve të duhura në ambientet përkatëse të dhomës së takimit. Dhoma ishte në kushte të mira, me piktura të përshtatura për të ofruar një ambient të këndshëm edhe për fëmijët. Gjithashtu institucioni ka vendosur kontakte me disa shoqata për të mundësuar materiale të ndryshme si broshura informative për të drejtat e fëmijëve dhe të miturve, lodra të ndryshme, etj... Ky program ka filluar të aplikohet në Qershor të 2015 ku marrin pjesë 35 të paraburgosura/dënuara. Gjithashtu praktikohet prindërimi në distancë deri në 8 orë në ditë, por mesatarisht nënat me fëmijët e tyre rrinë deri në 2 orë në ditë. Këto të fundit i takojnë fëmijët e tyre tek dhomat e takimit. Çerdhja ndodhej në kushte mjaft të mira për qëndrimin e nënave me fëmijë, të asistuara nga personel ndihmës.

Sa i takon **aktivitetet që ofroreshin**, ato konsistojnë në lojëra me letra, me domino, lojëra me top, kinema që organizohet një herë në javë, terapi arti, terapi okupacionale, etj. Institucioni prej vitesh ka vënë në funksionim serën e vet, ku janë të punësuar disa gra të cilat merren me rritjen e luleve apo perimeve të ndryshme. Çdo muaj, nga personeli social, plotësohet plani mujor i temave dhe bisedave të lira ose bisedave individuale. Temat kishin të bënin me marrëdhëniet në familje apo komunikimin mes të burgosurave me njëra tjetrën.

Referuar regjistrimit të masave disiplinore u konstatua se ishin marrë 6 masa disiplinore prej Janar- Korrik 2015, ku rezultonte se ishte përsëritëse një e burgosur. U konstatua se institucioni përpiqej të krijonte frymë bashkëpunuese ndërmjet të burgosurave, duke ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve me pajtim. Në këtë drejtim del në pah se nuk janë të shpeshta rastet e shkeljes së rregullores dhe e dhënies së masave disiplinore. Personat të cilët ishin nën masën disiplinore mbikëqyrreshin nga drejtuesi i institucionit dhe nga psikologjia.

Institucioni prej vitesh ka **bashkëpunim të mirë me disa OJF**, për të përmbushur nevojat të cilat nuk mund të mbulohen nga të ardhurat e pakta të institucionit. Këto bashkëpunime kanë konsistuar në organizimin e kurseve profesionale si: rrobaqepësi, parukeri apo kurs anglishteje dhe sekretarie. Ndër disa prej OJF-ve të përmendura më lart, janë CARITAS,

SHKBSH, “Save the Children” etj.. Vlen për t’u përmendur një iniciative e ndërmarrë me “Save the Children” ku është bërë i mundur realizimi i një programi prag lirimi dhe pas lirim të grave të burgosura, me qëllim mbështetjen e grave që lirohen nga burgu.

2.11 KONSTATIME TË TJERA

Nga monitorimi në IEVP Fier, po ashtu nga ankesat e shumta që KShH ka marrë nga të burgosurit e këtij institucioni, është konstatuar se dhomat e takimeve janë me strukturë të tillë që nuk mundëson komunikim të rregullt me familjarët, që shkojnë t’i vizitojnë të burgosurit, duke penguar kontaktin e drejtpërdrejtë me familjarët e tyre. Ka patur pretendime nga të dënuar, veçanërisht ata që kanë probleme me dëgjimin, të cilët shprehen se xhami i vendosur në dhomën e takimit dhe që i ndan nga vizitorët, pengon komunikimin dhe dëgjimin dhe komunikimin mes tyre. Në këto kushte çënohet *Neni 8⁷⁰ i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, për **respektimin e të drejtës për jetë familjare**.

Nga monitorimet ka rezultuar se ka pretendime për sjellje të dhunshme nga grupet e sigurisë të DPB-së. Këto pretendime janë paraqitur si problematike në raportin e mëparshëm dhe vijnë si probleme edhe gjatë 2015. KShH, kujton se çdo detyrë e marrë përsipër nga cilido funksionar shtetëror duhet të realizohet në përputhje me ligjin, me parimet e drejtësisë dhe të barazisë. Sjelljet e dhunshme janë të dënueshme, në rastet kur nuk pajtohen me nevojën proporcionale të zgjidhjes së konfliktit të mundshëm. Strukturat e sigurisë pranë DPB duhet të jenë një model i mirë për respektimin e ligjit dhe të rregullores së institucionit.

Bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm në një institucion të privimit të lirisë është një ndër elementët kyç që ndihmon në realizimin e qëllimit të institucioneve penitenciare. Nuk mund të kuptohet organizimi i aktiviteteve social-kulturore dhe i shërbimit shëndetësor pa bashkëpunuar ndërmjet gjithë sektorëve, punonjësit shëndetësor, ata të sektorit social dhe punonjësit e policisë së institucionit. Ky bashkëpunim sjell ndikimin e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë tek rehabilitimi i të burgosurit, tek cilësia e shërbimit shëndetësor dhe në garantimin e sigurisë në institucion.

70. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

Qëndrueshmëria e personelit në sistemin penitenciar është mjaft e rëndësishme për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e ecurisë së punës së institucioneve. U konstatua se personeli punonjës nuk ishin të motivuar dhe kishte lëvizje të shpeshta të pozicioneve të punës. Nga ana tjetër trajnimi vazhdues i tyre ndikon në rritjen e profesionalizimit. Gërshetimi i eksperiencës në punë me pjesëmarrjen në trajnime të ndryshme sjell një trajtim më rehabilitues dhe human të personave të privuar nga liria. Investimi i realizuar në rritjen e kapaciteteve të personelit duket të ketë vazhdimësi dhe të jap rezultat të dukshme në vijim. Personeli duhet të jetë i motivuar për të kryer detyrën dhe për këtë nevojitet qëndrueshmëria në vendet e punës.

II. SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Nëpërmjet burgimit, individëve u kufizohen disa të drejta, veçanërisht ajo e lirisë individuale dhe lirisë së lëvizjes, por ata duhet të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tjera themelore të njeriut, si dhe të trajtohen në respekt të dinjitetit human, sepse janë qenie njerëzore.

KShH, nisur nga gjetjet dhe konstatimet e monitorimeve të realizuara në institucionet e sistemit Shqiptar të burgjeve, si dhe pasi i diskutoi këto gjetje me drejtuesit e autoriteteve lokale dhe autoritetet drejtuese të DPB, prezanton më poshtë disa sugjerime, të cilat do të ndihmojnë për të përmirësuar situatën.

1. Për të ulur e parandaluar mbipopullimin në burgje, institucionet kompetente të sistemit të drejtësisë duhet të komunikojnë e bashkëpunojnë më mirë ndërmjet tyre. Një zgjidhje efçente në këtë drejtim është zbatimi i dënimeve alternative dhe shtimi i rasteve të mbikëqyrjes elektronike, ulja e rasteve të aplikimit të masës së sigurimit “Arrest me burg”, si kanë rekomanduar edhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë si p.sh. Prezenca e OSBE në Shqipëri.
2. KShH sugjeron që të merren masa konkrete për të përpunuar buxhetimin e DPB me nevojat konkrete të IEVP-ve dhe IP me qëllim që të respektohen të gjitha standardet ligjore dhe ndërkombëtare për trajtimin e të burgosurve dhe paraburgosurve, veçanërisht, për të miturit, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë.
3. Nevojitet të rritet kujdesi për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë nëpër sektorë dhe në ambientet e realizimit të aktiviteteve

sportive, ajrimit etj.. Sugjerohet që personeli mjekësor, ashtu siç sanksionohet në ligj, të angazhohet periodikisht në inspektimin e higjienës dhe pastërtisë në këto institucione, duke garantuar mbajtjen e ambienteve të pastra, jashtë dhe brenda institucioneve.

4. KShH sugjeron trajtimin e diferencuar dhe sipas nevojave për kategoritë vulnerabël të të burgosurve. Po ashtu, në vijim të bashkëpunimit dhe ngritjes së kapaciteteve të personelit të sistemit shqiptar të burgjeve, KShH sugjeron realizimin e trajnimeve vazhduese për personelin e IEVP/IP-ve për rritjen e kapaciteteve të ekipeve multi-disiplinore nëpërmjet përdorimit të instrumenteve ndihmues për vlerësimin individual të të paraburgosur/dënuarve me probleme të shëndetit mendor, si edhe për hartimin e planeve fillestare të trajtimit dhe planeve të udhëzimit të trajtimit në vazhdimësi për këta persona. KShH sugjeron që këto instrumente të bëhen pjesë e praktikës së punës së përditshme me këta pacientë në të gjitha IEVP-të.
5. Pavarësisht nismës së mirë të ndërmarrë për hapjen e SKV-ve, KShH sugjeron që ndaj këtyre të sëmurëve të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, të shtrojave dhe veshjeve personale, si dhe të mjedisit që i rrethon.
6. Shërbimi shëndetësor duhet të përmirësojë cilësinë, si porsa u përket vizitave periodike, ashtu dhe mjekimeve të ofruara për personat me probleme të shëndetit mendor. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar stigmës dhe paragjykimëve që mund të lindin nga të burgosurit apo personeli i institucioneve për trajtimin e kësaj kategorie të personave me liri të kufizuar.
7. Problem tejet shqetësues mbetet mbajtja në burgje i personave me vendim gjyqësor me masë “Mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor” dhe “Shtrim të përkohshëm” gjë që është në shkelje flagrante me ligjin dhe të drejtat e këtyre personave. KShH i bën thirrje të gjithë institucioneve shtetërore relevante të gjejnë zgjidhje të shpejta në përputhje me ligjin dhe efektive, për të vënë në vend cënimin flagrant dhe të vazhdueshëm të të drejtave të këtij grupi individësh që mbahen në burgje.
8. Pajisja me personel mjekësor psikiatër , sipas nevojave të institucioneve, ka rëndësi të veçantë në kushtet ku në burgje mbahen rreth 164 persona më masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor” dhe “Shtrim të përkohshëm”. Mbulimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik në IEVP Zahari Krujë, nga

mjekja e IVSHB Tiranë dhe IEVP Durrës është një zgjidhje jo optimale dhe definitive. Sugjerojmë që, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, të studiohet mundësia për krijimin e lehtësirave institucionale për punësimin e mjekëve psikiatër, me kohë të plotë, në IEVP dhe IP.

9. Të merren masa të menjëhershme për plotësimin e personelit kujdestar të mjaftueshëm në institucionin e Zaharisë, Krujë, sepse mungesa e tyre shkakton rrethana për trajtim çnjerëzor dhe degradues ndaj personave me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, që trajtohen në këto institucione.
10. KSHH sugjeron gjithashtu, ndërmarrjen e hapave konkretë për përmirësimin e legjislacionit që shpërblen punën e kryer nga të burgosurit, si dhe të zgjidhet problematika e pagesës së tyre, sikurse sanksionohet në ligj.
11. KSHH sugjeron që t'i kushtohet vëmendje e duhur zgjidhjes së çështjes së dhënies së lejeve shpërblyese për të burgosurit shtetas të huaj. Ata duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta sikurse shtetasit shqiptar, me përjashtim të atyre të drejtave të përcaktuara në dispozita të posaçme.
12. Për sa i takon trajtimit të të miturve, KShH dëshiron të sugjerojë kujdes të veçantë për përmirësimin e mirëmbajtjes së higjienës në disa prej dhomave/mjediseve të qëndrimit të të miturve. Përcaktimi i objektivave konkretë në planin individual të dënimit të gjithsecilit të mitur dhe më tej puna e ekipeve multi-disiplinare me ta, do të ishte një faktor me efekt pozitiv për arritjen e këtyre objektivave. Zbatimi i teknikës së formateve të aftësive sociale, si një teknikë tejet praktike dhe e dobishme do të ndihmonte për t'i aftësuar të miturit të fitojnë aftësi sociale dhe përkujdesin ndaj vetes, bashkëjetesës në komunitet etj.
13. Me rëndësi për këtë grup-moshë në konflikt me ligjit, është përfshirja e familjarët/të afërmve të të miturve në procesin e hartimit të planit individual të dënimit, si dhe në vijimësi të trajtimit të të miturve në institucionet ku mbahen të miturit.
14. KShH sugjeron trajnime të vazhdueshme të personelit që punon me të miturit sa i takon zbatimit të masave edukuese dhe atyre disiplinore ndaj të miturve, për të pasur një kuptueshmëri të njëjtë dhe realizim korrekt të tyre në praktikë nga gjithë personeli me uniformë dhe ai civil.

15. Për sa i takon trajtimin të grave të burgosura, KSHH dëshiron të nxisë autoritetet shtetërore për të përsheptuar planet për ndërtimin/rikonstruktimin e institucionit ku do të qëndrojnë gratë e burgosura. Nevojat në këtë drejtim janë urgjente.
16. KShH gjithashtu sugjeron që IEVP Ali Demi, të marrë masa për përmirësimin e menjëhershëm të ambienteve të veçimit, të cilat nuk plotësojnë standardet e duhura, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mbajtja e grave nën masë disiplinore në këto ambiente përbën trajtim çnjerëzor.
17. KShH dëshiron të nënvijëzojë edhe një herë rëndësinë e bashkëpunimit midis sektorëve të ndryshëm të punës në burgje dhe punën në ekipe multi-disiplinare. Po ashtu, qëndrueshmëria në marrëdhëniet e punës për punonjësit është element i rëndësishëm për përmbushjen me cilësi dhe profesionalizëm të detyrave funksionale të tyre.

KREU 3. SITUATA NË SPITALET PSIKIATRIKE

3. GJETJE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE QË VUAJNË NGA ÇRREGULLIME TË SHËNDETIT MENDOR NË SPITALET PSIKIATRIKE

Për evidentimin e situatës aktuale në spitalet psikiatrike janë monitoruar 4 institucione, konkretisht: Spitali Psikiatrik i Elbasanit, Spitali Psikiatrik i Tiranës, Spitali Psikiatrik i Vlorës dhe Shërbimi i Shëndeti Mendor i Specializuar me Shtretër në Shkodër dhe disa shtëpi mbështetëse pranë këtyre institucioneve. Fokusi i këtyre monitorimeve ka qenë monitorimi i respektimit të të drejtave të personave më probleme të shëndetit mendor që janë akomoduar në këto institucione. Në misionet e monitorimit janë angazhuar 12 vëzhgues të tillë si mjek, jurist dhe punonjës social me eksperiencë të gjatë në fushën e të drejtave të njeriut. Institucionet e monitoruara bashkëpunuan për realizimin e misioneve të monitorimit duke krijuar akses dhe lehtësirat e nevojshme për përmbushjen e misionit.

3.1 PERSONELI MJEKËSOR

Personeli mjekësor që punon në këto institucione përballlet me vështirësi të ndryshme, por situatat e vështira i menaxhojnë me profesionalizëm. Nga monitorimi në këto institucione na ka rezultuar se, në mjaft raste, vështirësitë në punë shtohen për shkak të mungesës së personelit. Në këtë drejtim më problematike u paraqit situata në institucionin e Shkodrës dhe të Elbasanit. U konstatua se stafi mjekësor në institucionin e Elbasanit nuk ishte i mjaftueshëm në raport me numrin e pacientëve. Në të gjithë institucionin ishin 3 mjek psikiatër. Në një pavijon qëndronin rreth 70 pacientë për të cilët kujdeseshin rreth 3 staf mjekësor për çdo turn përfshirë mjek dhe infermier. Në raport me institucionet e tjera, SP Vlorë rezultoi se kishte mjaftueshëm staf mjekësor përfshirë infermier. Në institucionin e Shkodrës rezultoi një mjeke psikiatre që mbulonte

shërbimet për shëndetin mendor. Ekzistenca e një mjeku të vetëm sillte probleme për zbatimin e procedurës ligjore për trajtimin e pavullnetshëm.

3.2 PRANIMI NË INSTITUCION

Nga monitorimet rezultoi se përgjithësisht pacientët referoheshin në spital nga mjeku i familjes, mjekët e rretheve dhe mjeku psikiatër i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor. Pacientët, që fillimisht ishin paraqitur si raste urgjente, më pas kalonin në pavijonet përkatëse për kronikë ose akutë. Pacientët rezultuan të kartelizuar dhe nëpër institucione realizoheshin vizita mjekësore periodike sipas protokolleve në fuqi.

Në ditën e parë të pranimit në institucion pacienti i nënshtrohet ekzaminimeve rutinë si dhe ekzaminimeve më të detajuara në varësi të problematikave. Mjeku bënte me dije pacientin për diagnozën dhe trajtimin mjekësor. Pacientët firmosnin deklaratën e pranimit në kartelën mjekësore. Nga monitorimi rezultoi se pacientit, ose kujdestarit të tij nuk i jepej një kopje e kësaj deklarate, në pjesën më të madhe të rasteve. Nëse pacienti nuk dëshironte të hospitalizohej në mënyrë të vullnetshme, procedohej sipas procedurës së trajtimit të pavullnetshëm. Fillimisht, pacienti vlerësohej nga mjeku së bashku me psikologun dhe punonjësën social, e më pas realizohej plani i trajtimit.

3.3 AKOMODIM

Vërehen standarde të ndryshme të akomodimit në institucionet e monitoruara. Spitalet psikiatrike, që ishin rikonstruktuar/ndërtuar vitet e fundit (SP Tiranë, SP Shkodër dhe një pjesë e SP Vlorë), kishin standarde të mira akomodimi të pacientëve. Përgjithësisht dhomat ishin me hapësira të mjaftueshme, dritë natyrale dhe me ajrosje. Nëpër dhoma qëndronin nga 1 deri në 3 persona. Në shumicën e rasteve, dhomat e pacientëve ishin të pajisura me televizorë, dollapë personale dhe tavolina, si dhe ishin të lyera, të mirëmbajtura e të pastra higjienikisht. Secili pacient kishte shtrojet e veta personale, të cilat pastroheshin periodikisht në lavanderinë e institucioneve.

Në Spitalin Psikiatrik Tiranë ofrohej edhe shërbim psikiatrik për të mitur dhe adoleshentë. Kushtet në këtë godinë të veçantë ishin mjaft të mira. Dritaret mundësonin dritë të mjaftueshme natyrale dhe dhomat ishin të ajrosura. Pastërtia dhe rregulli vihej re që në hyrje të institucionit, nëpër dhoma dhe ambientet e përbashkëta. Çdo dhomë ishte e pajisur me pajisjet

e nevojshme. Pacientët kishin komoditat e tyre për të vendosur sendet personale. Shtrojet rezultuan të pastra dhe të reja. Tualetet ndodheshin jashtë dhomave dhe të pajisur me detergjentët e nevojshëm. Godina ishte e pajisur me sistem ngrohje i cili funksiononte rregullisht. Gjithsesi, vihej re mospërshtatje e ngjyrave të përdorura në mjedis për këtë grup-moshë pacientësh.

E kundërt paraqitej situata e konstatuar në institucionet e vjetra (si në SP të Elbasanit dhe në pavijonin e kronikëve në SP të Vlorës) ku dhomat ishin në formën e kapanoneve, të cilët akomodonin në rastet më ekstreme deri në 13 shtretër në dhomë. Në SP të Elbasanit u konstatua mbipopullim prej 30 pacientësh. Shpesh, pacientët nuk kishin teshat e tyre personale, por ato i shkëmbenin me pacientët e tjerë, sipas “udhëzimeve” të personelit. Po ashtu, nëpër dhoma kishte vetëm krevatet e pacientëve dhe asgjë tjetër. Tualetet ishin me lagështirë dhe vinin aromë të rëndë. Dushet nuk ishin në funksion të plotë.

Nga monitorimi rezultoi se spitali psikiatrik i Elbasanit kishte një strukturë të mbyllur. Në këtë spital trajtohen rreth 340 pacientësh, ndër të cilët 80 prej tyre kishin prapambetje mendore. Institucioni i ndërtuar që në vitin 1964, nuk përmbush standardet infrastrukturore aktuale për trajtimin e të sëmurëve psikiatrik. Ligji “Për shëndetin Mendor” parashikon se, një nga parimet më të rëndësishme në shërbimet e shëndeti mendor, është ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur, në maksimum, zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.

Një çështje shqetësuese, që u konstatua, ishte mbajtja në spitalet psikiatrike e pacientëve me prapambetje të thelluar mendore, të cilët nuk kanë nevojë për trajtim medikamentoz, ndaj dhe nuk duhet të qëndrojnë aty. Pjesa më e madhe e tyre janë të abandonuar nga familja. Shpesh, spitalet psikiatrike gjenden në vështirësi për zgjidhjen e këtij problemi, i cili mbingarkon punën e të gjithë personelit dhe specialistëve. Ministria e Mirëqenies Sociale, si ministria e linjës që ka për detyrë kujdesin ndaj këtyre pacientëve, duhet të ndër marrë hapa konkretë për akomodimin e tyre në ambiente të veçanta jashtë spitaleve psikiatrike.

3.4 TRAJTIMI I PAVULLNETSHËM DHE MJEKIMI I DETYRUAR

Sipas ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, rezulton se **subjekt i trajtimit të pavullnetshëm** është personi, i cili shtrohet në **mënyrë të pavullnetshme** në shërbimet e shëndetit mendor të **specializuar me shtretër**, ose pasi është **shtruar në mënyrë të vullnetshme mbahet në mënyrë të pavullnetshme**, sipas përcaktimit të mjekut specialist. **Vendimi për trajtim të pavullnetshëm** të një personi me probleme të shëndetit mendor, fillimisht, merret nga **mjeku specialist** vetëm pasi të ketë kryer personalisht ekzaminimin e tij⁷¹.

Nga monitorimet ka rezultuar se stafi mjekësor kishte dijeni lidhur me afatin ligjor për vendosjen e një pacienti në trajtim të pavullnetshëm dhe të procedurës ligjore që duhet ndjekur në të tilla raste. Më së shumti, ishte personeli juridik, që ishte i pozicionuar pranë organit drejtues të institucionit, që ndiqte këtë problematikë pranë gjykatave kompetente, por pikërisht ky personel rezultoi se kishte mangësi në njohuritë ligjore në këtë drejtim. Për pasojë, shpesh, ndjekja e rasteve në gjykatë, kryhej tej afateve dhe në shkelje të procedurës së parashikuar në ligj, duke lejuar dhe shkelje të drejtave të tjera të pacientëve që i nënshtrohen kësaj procedure.

Për arsye të mungesë së stafit mjekësor, në disa raste nuk zbatohet procedura ligjore për vendosjen e një personi në trajtim të pavullnetshëm, praktikë për të cilën kërkohen 3 firma të mjekëve të ndryshëm, të cilët kryejnë bashkërisht vlerësimin e gjendjes së tij shëndetësore. Në institucionin e Shkodrës ishte e punësuar vetëm një mjeke psikiatre, e cila, në kundërshtim me ligjin, ishte e vetmja që vendoste për personat që i nënshtroheshin trajtimit të pavullnetshëm.

71. Mjeku që vendos për trajtimin e pavullnetshëm në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për shtrimin e pavullnetshëm, brenda 24 orëve. Shefi i shërbimit, jo më vonë se 24 orë nga vendosja në trajtim të pavullnetshëm, urdhëron me shkrim në kartelën mjekësore rivlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit të shtruar në mënyrë të pavullnetshme. Rivlerësimi kryhet nga personeli mjekësor që nuk ka marrë pjesë në procedurën fillestare të shtrimit dhe trajtimit të pavullnetshëm. Pas rivlerësimit të gjendjes shëndetësore, personeli mjekësor plotëson kartelën mjekësore me të gjitha shënimet e nevojshme dhe referon pranë shefit të shërbimit nëse trajtimi i pavullnetshëm është i bazuar apo i pabazuar, ose kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte të tilla. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se nuk kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte trajtimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të marrë trajtimin e pavullnetshëm në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda 48 orëve, titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor për të vlerësuar procedurën e kryer. Gjyqtari i vetëm e shqyrton kërkesën e paraqitur nga titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e trajtimit të pavullnetshëm, jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e saj.

Nga këqyrja e materialeve përkatëse në dosjet mjekësore të personave me trajtim të pavullnetshëm, në të shumtën e rasteve rezultoi se kishte mungesë të dokumentacionit ligjor të nevojshëm si: kërkesa drejtuar gjykatës për vendosjen në trajtim të pavullnetshëm; kërkesa për revokimin e trajtimit të pavullnetshëm; etj.⁷² Në pjesën dërrmuese nuk i jepej pacientit, ose kujdestarit të tij, një kopje e deklaratës së pranimit në institucion, vendimi për trajtim të vullnetshëm ose pavullnetshëm.

Nga këqyrja e vendimeve gjyqësore lidhur me pacientët e shtruar më institucionet e monitoruara, u konstatuan raste të përdorimit jo të saktë, nga gjykatat, i koncepteve ligjore lidhur me masën mjekësore të “Mjekim i detyruar pranë një institucioni shëndetësor” ose “Shtrim i Detyruar” dhe institutit “Trajtim i pavullnetshëm”. Gjatë monitorimit na u referua se ka vonesa, nga gjykatat, në shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga institucionet shëndetësore, duke tejkaluar afatin për shqyrtimin e kërkesave, që ligji e ka parashikuar në 48 orë, nga momenti i paraqitjes së tyre.

Janë evidentuar raste kur proceset gjyqësore ndiqeshin nga mjekja e institucionit ose nga punonjësja sociale. Pavarësisht rrethanave të ndryshme, nuk është detyrë e mjekut dhe e punonjësit social të ndjekë seancat gjyqësore në mënyrë të përsëritur. Juristët e këtyre institucioneve duhet të realizojnë punën e tyre me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri.

Në një dosje mjekësore, të një personi me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor”, nuk u gjet vendimi i rishikimit të masës së dhënë, ndonëse kishte kaluar afati një vjeçar. Ky person qëndronte në SP Vlorë që nga viti 2006. Spitali pretendonte se gjykata nuk e kishte rishikuar masën e dhënë ndaj tij asnjëherë, ndonëse legjislacioni e detyron gjykatën ta kryejë këtë vlerësim jo më rrallë se një herë në vit.

3.5 KUFIZIMI FIZIK

Nga monitorimet ka rezultuar se Spitali Psikiatrik i Vlorës është i vetmi institucion që ka regjistrat e kufizimit fizik dhe të shtrimit të

72. Nga komunikimet zyrtare me Ministrinë e Shëndetësisë rezultoi se mbështetur në Ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” si dhe në rekomandimet e Komitetit të Parandalimit të Torturës dhe Mekanizmave Kombëtare për Parandalimin e Torturës, Drejtoria e QSUT ngriti Urdhrin e Brendshëm Nr 104 datë 10.04.2015 “Për hartimin e procedurës standarte për administrimin e dosjeve individuale për procedurat e Gjykatës për Trajtimin e Pavullnetshëm për pacientët në Shërbimin e Psikiatrisë” dhe grupi i punës përgatiti në datë 20.05.2015 “Rregulloren mbi dokumentimin e procedurës së trajtimit të pavullnetshëm dhe administrimin e dosjeve individuale të pacientit”. Kjo Rregullore i është bërë e njohur stafit të Urgjencës pranë këtij Shërbimi, pra personelit mjekësor, si të ngarkuarit me ligj për zbatimin e saj.

pavullnetshëm dhe dhomë të kufizimit fizik me standardet e duhura ligjore.⁷³ Këto regjistra ishin plotësuar sipas rubrikave përkatëse dhe me korrektësi. Në institucionin e Elbasanit dhe të Shkodrës rezultoi se nuk kishte dhoma të kufizimit fizik dhe nuk kishin mjetet e kufizimit fizik. Në Spitalin Psikiatrik të Tiranës ekzistonin 2 dhoma që kryenin këtë funksion⁷⁴, por ishin jashtë çdo standardi dhe përbënin rrezik për jetën e pacientëve të axhituar pasi të jepnin përshtypjen e dhomave të burgjeve. Nga personeli i SP në Tiranë ishte ngritur një grup pune lidhur më ndërtim e këtyre dhomave me standardet e duhura.

3.6 E DREJTA PËR USHQIM

Nga monitorimet u konstatua se nuk pati pretendime për cilësinë e ushqimit. Vaktet i përshtateshin stinës dhe ishin të mjaftueshme për një person. Nuk mungonte shumëllojshmëria e ushqimit duke alternuar vaktin kryesor me fruta. Në këtë drejtim Spitali Psikiatrik Tiranë ishte një shembull i mirë⁷⁵. Ushqimi, përgjithësisht, përgatitej dhe sillej nga kompania e kontraktuar dhe konsumohej në ambientet spitalore. Mëngjesi konsumohej në orën 08:00 të mëngjesit, në orën 9 ofrohej kafe, çdo ditë, për të gjithë pacientët, në ambientet e institucionit. Në 12:30 konsumohej dreka, në orën 16:00 pasdite ofrohej diçka e lehtë (fruta ose diçka e përgatitur) dhe në orën 19:00 ofrohej darka⁷⁶. Vakti për personat diabetikë ose për ata të cilët mjeku kishte urdhëruar një dietë të veçantë, ofrohej më vete nga ushqimi i përgjithshëm, i cili rezultoi të ishte në kushtet e duhura higjienike. Pothuaj në të gjitha institucionet e monitoruara këto ishin pak a shumë oraret e shërbimit të vakteve të ushqimit.

Ushqimi, në momentin e mbërritjes në institucion, i nënshtrohej kontrollit nga një grup pune, për të vlerësuar cilësinë e tij, kundrejt firmosjes së procesverbalit përkatës. Nga monitorimi i magazinave ku ruhej ushqimi, u konstatua se kishte mjaftueshëm furnizim për të përballuar nevojat e institucionit të tilla si reçel, kafe, sheqer, makarona, etj.⁷⁷ Ambientet

73. Në pavionin e urgjencës në SP Tiranë ishte improvizuar një rregjistër i kufizimit fizik në mungesë të modelit standard nga MSH. Nga komunikimet zyrtare me Ministrinë e Shëndetësisë, rezultoi se këto regjistra janë prodhuar nga QSUT në Nëntor të vitit 2015 dhe Shërbimi i Psikiatrisë është pajisur me regjistrat standard më datë 01.03.2016. Sa i takon dhomës së kufizimit fizik QSUT i është drejtuar me shkkresë zyrtare Ministrisë së Shëndetësisë për alokimin e buxhetit për investime për QSUT përfshirë dhe dhomat për kufizimin fizik;

74. Pavioni i burrave;

75. Shërbehej gjellë me spinaq, patate, kek, gjellë me lakër dhe karrota, romstek mishi, komposto, etj.

76. Referuar Shërbimit të Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër Shkodër;

77. Id;

e kuzhinës ishin në kushte të përshtatshme për të konsumuar ushqim me komoditetet e nevojshme në ambiente të pastra, me dritë natyrale, tavolina dhe karrike.

3.7 AKTIVITETET REHABILITUESE

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme rehabilituese luan një rol të rëndësishëm në rehabilitimin e personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor në këto institucione. Nga monitorimet ka rezultuar se organizohen aktivitetet të ndryshme si: lojëra tavoline, aktivitete sportive si ping-pong, lojëra me top, shëtitje në qytet ose në vende të ndryshme si p.sh. në plazh gjatë verës, leximi i librave të ndryshëm, orë kreative, si dhe ndjekja e programeve të ndryshme televizive⁷⁸. Por, përgjithësisht, pacientët që angazhoheshin në këto aktivitete përbënin një numër relativisht të ulët në raport me numrin e përgjithshëm të pacientëve.

Për pacientët që mund ta përballonin fizikisht organizoheshin aktivitete sportive, ato kryheshin deri në 4 herë në javë, nga 2-3 orë. Përgjithësisht personat që qëndronin në shtëpitë mbështetëse mund të dilnin pa shoqërimin e kujdestarëve nëse gjendja e tyre shëndetësore ia lejonte. Me miratimin e mjekut pacientët mund të kalonin fundjavën pranë familjarëve të tyre.

Në shtëpitë mbështetëse pranë këtyre institucioneve zbatohet programi i psiko-edukimit. Ky program konsistonte në pastrimin e ambienteve nga pacientët, higjienizim personal, terapi okupacionale, gatim, etj. Meshkujt në periudhën e verës merrnin pjesë në kalçeto një herë në dy javë⁷⁹. Në shtëpitë mbështetëse në Elbasan për personat të cilët kishin prapambetje mendore organizoheshin orë shkrimi dhe leximi⁸⁰. Në shtëpinë mbështetëse në Shkodër ishte realizuar krijimi i një lavazhi social ku angazhoheshin pacientët gjatë periudhës së verës për larjen e automjeteve me kosto më të ulët se tregu.

Në shërbimin e psikiatrisë për fëmijëve dhe adoleshentë, pranë QSUT “Nënë Tereza”, gjendeshin 2 salla aktiviteteve të arregjuara më së miri e të përshtatura për moshat e pacientëve që qëndrojnë në këtë institucion. Të miturit merreshin me punë krijuese, plotësimin e lojërave formuese, pikturë, etj...

78. Në këtë drejtim rezultoi se aktivitetet sociale realizoheshin më të plotë e të shumta në Spitalin Psikiatrik në Vlorë;

79. Referuar Shërbimit të Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër Shkodër;

80. Ky aktivitet zhvillohej prej 2 vitesh në kuadër të një projekti Holandez;

3.8 HIGJIENA PERSONALE DHE VESHJET

Pacientët, gjatë kohës së hospitalizimit, furnizohen me veshmbathje, shapka, veshje sportive dhe pizhame. Çarçafët ndërroreshin dy herë në javë (në raste të veçanta edhe më shpesh)⁸¹. Krevatet ishin të pajisur me çarçafë e batanije të mjaftueshme për të përballuar të ftohtin. Institucionet kishin lantanteri ku higjienizohen rrobat, çarçafët e batanijet e pacientëve⁸². U vëzhguar magazina e veshmbathjeve ku u vunë re, batanije, pallto, pantofla dhe rroba të tjera të ndryshme të nevojshme. Në institucionin e Vlorës ishte e punësuar një rrobaqepëse për të riparuar rrobat e dëmtuara të pacientëve. Rezultoi se kishte furnizim me detergjentët e nevojshëm për të mbajtur pastër ambientin dhe shtrojet personale të tilla si, detergjent për larjen e teshave, ambienteve, ilaçe kundër insekteve etj.. Në Spitalin Psikiatrik në Elbasan rezultoi se disa paciente vishnin të njëjtat veshje, që të jepnin përshtypjen se ishin shumë të vjetra dhe të konsumuara. Pacientët mund të përdornin veshjet e tyre, por edhe spitali i siguronte në momentin e parë të mbërritjes në institucion. U konstatua se përgjithësisht kishte mjaftueshëm furnizim me veshje të tilla si rroba të përditshme dhe batanije.

Përgjithësisht pacientët rezultuan të pastër e të rregullt me përjashtim të personave të cilët ishin në gjendje mjaft të rënduar shëndetësore dhe nuk mund të kujdeseshin për veten. Pacientët mund të bënin dush pa hasur probleme madje edhe përditë kur e kishin të nevojshme. Nuk u konstatua mungesë e furnizimit me ujë.

3.9 MARRDHËNIET ME BOTËN E JASHTME

Marrëdhëniet me familjarët paraqiten jo të mira për shumë pacientë. Pjesa më e madhe e personave që kanë vite që qëndrojnë në këto institucione janë të harruar nga familja. Pjesa tjetër e personave që shtrohen në këto institucione për periudha të shkurtra kanë kontakte me familjen.

Nga monitorimet doli në pah si problem, marrja e pensioneve të pacientëve nga familjarët. Personat e hospitalizuar në këto ambiente kanë zotësi për të vepruar (me përjashtim të atyre që nuk është hequr ose kufizuar me vendim gjykatë) dhe mund t'i administrojnë vetë këto të ardhura. Për aq kohë sa janë institucionet që kujdesen për këtë kategori, nuk është e ligjshme që pensioni të merret e të shpenzohet nga të afërmit e tyre.

81. Në Vlorë çarçafët ndërroreshin përditë dhe shtretërit ishin të veshur me material plastik për të ruajtur pastërtinë e pacientëve;

82. U konstatua në Shkodër dhe në Vlorë;

3.10 MARRDHËNIET PACIENT-STAF

Nuk u paraqitën pretendime për dhunë fizike ose psikologjike nga stafi punonjës kundrejt pacientëve. Stafi mjekësor rezultoi me eksperiencë, të kualifikuar dhe me qasje pozitive ndaj pacientëve. Kjo u vërejt në të gjitha institucionet e monitoruara. U konstatua marrëdhënie e mirë ndërmjet punonjësve dhe pacientëve. Edhe në rastet kur pacientët shfaqeshin të axhituar ose paraqiteshin për herë të parë në institucion me sende të ndaluara, rezultoi se këto situata përballoheshin me profesionalizëm dhe në bashkëpunim të ngushtë me policinë, kur paraqitej e nevojshme.

III. SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR NË SPITALET PSIKIATRIKE

- Duke vlerësuar ndërhyrjet në përmirësimin e infrastrukturës në spitalet psikiatrike të Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës (pjesërisht), sugjerojmë që ato të kryhen, sa më parë dhe në Elbasan dhe në pavijonin e kronikëve në SP në Vlorë.
- KSHH sugjeron që të vazhdohet të përmirësohen kushtet infrastrukturore, me qasje kundrejt trajtimit të individualizuar të pacientëve, duke ofruar një trajtim më gjithëpërfshirës për pacientët.
- Roli i mjekëve psikiatër është kyç në trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor. Për të patur një shërbim efektiv psikiatrik dhe konform akteve ligjore në fuqi duhet të punësohet staf mjekësor i mjaftueshëm (mjek dhe personel mbështetës) në institucionet të cilat kanë nevojë. Ministria e Shëndetësisë duhet të rritë numrin e mjekëve që specializohen në këtë drejtim sepse nevojat janë në rritje.
- KShH sugjeron, gjithashtu, që gjykatat të shqyrtojnë me kujdes dhe brenda afateve të parashikuara në ligj, rastet e trajtimit të pavullnetshëm në SP, duke garatuar proces të rregullt ligjor, si dhe duke përfshirë sa më shumë që të jetë e mundur vetë personat e sëmurë mendorë gjatë shqyrtimit të çështjeve të tyre.

- Së fundmi, KShH sugjeron të realizohen trajnime të vazhdueshme të stafit mjekësor (të nivele të ndryshme), stafet ligjore dhe stafit që ofron shërbime sociale, me qëllim përfitimin e njohurive të thelluara profesionale të koncepteve ligjore “Trajtim i pavullnetshëm”, “Mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor” dhe “Shtrim i Përkohshëm”. Këto trajnime do të ndihmojnë stafin e SP të respektojë procedurat ligjore në këto drejtime, për të garantuar në thelb të drejtat e parashikuara për këtë kategori personash.

LISTA E MONITORUESVE TË INSTITUCIONEVE

1. Albana Misja - Juriste
2. Alban Muriqi - Jurist
3. Anita Pilika - Mjeke
4. Andi Muratej - Jurist
5. Andia Haxhi - Juriste
6. Ariana Rreli - Mjeke
7. Ardita Çota - Juriste
8. Besim Ymaj - Mjek
9. Doruntina Krraba- Psikologe
10. Ela Tollkuçi - Psikologe
11. Elton Frashëri - Jurist
12. Edis Ibrahim - Jurist
13. Ervis Çota - Aktivist i të Drejtave të Njeriut
14. Fatmire Haliti - Juriste
15. Gëzim Myftari - Mjek
16. Ilir Mica - Mjek
17. Iva Bregasi - Juriste
18. Irismilda Gjonaj - Punonjëse Sociale
19. Jelena Mirkov - Juriste
20. Klejda Ngjela-Juriste/Shkenca Sociale
21. Klodian Gjermani - Jurist
22. Liljana Palibrk- Juriste
23. Neda Chalovska - Juriste
24. Petro Thanasi - Mjek
25. Skerdian Kurti - Jurist
26. Valbona Tahiraj - Mjeke
27. Voislav Stojanovski- Jurist